



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 58

Tiranë – E martë, 13 prill 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 7.4.2021	Për miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet “Human Vaccine” LLC dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën kundër COVID-19 “Sputnik V”, të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit Gamaleya për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi.....	5633
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 7.4.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugicës në rrugën ‘Besa’, lagja nr. 1 ‘Barrikadë’”, Berat.....	5633
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 220, datë 7.4.2021	Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike.....	5635
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 222, datë 7.4.2021	Për miratimin e listës së substancave kandidate.....	5643
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 8, datë 8.4.2021	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për dhënien e medaljes së artë nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë.....	5696
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 9, datë 9.4.2021	Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2020–2021 (sesioni i parë).....	5697
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 11.3.2021	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 387/1, datë 28.2.2019, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	5698
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 73, datë 12.3.2021	Mbi miratimin e “Rregullores mbi procedurat për dhënien e së drejtës së përjashtimit, për infrastrukturën e re të gazit natyror”.....	5705

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 74, datë 12.3.2021	Mbi miratimin e objektivave strategjike të ERE-s për periudhën 2021–2023.....	5710
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 19.3.2021	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar”.....	5723
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 76, datë 19.3.2021	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “E-Vento SRL Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021.....	5723
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 77, datë 19.3.2021	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a., për miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50(3) dhe 51(1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”.....	5725
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 23.3.2021	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	5727
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 4308, datë 9.4.2021	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	5728
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 21/8, datë 9.4.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tregut të gjësë së gjallë”, Bashkia Korçë.....	5728



AKT NORMATIV
Nr. 16, datë 7.4.2021

**PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË
MARRËVESHJES NDËRMJET “HUMAN
VACCINE” LLC DHE MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRI
TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN TË
SHQIPËRISË DHE INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK, PËR
FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË ME VAKSINËN KUNDËR
COVID-19 “SPUTNIK V”, TË
ZHVILLUAR NGA INSTITUTI
KOMBËTAR I KËRKIMIT GAMALEYA
PËR EPIDEMIOLOGJINË DHE
MIKROBIOLOGJINË NË RUSI**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i tekstit të marrëveshjes

1. Miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet “Human Vaccine” LLC dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën “Sputnik V”, të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit Gamaleya për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi.

2. Marrëveshja për furnizimin ndërmjet “Human Vaccine” LLC dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë dhe Institutit të Shëndetit Publik për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga “Human Vaccine” LLC nuk do të publikohet në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.

3. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit e të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë

publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

4. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për furnizimin e vaksinës kundër Covid-19 “Sputnik V”, të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit Gamaleya për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi, furnizuar për Shqipërinë nga “Human Vaccine” LLC, sipas kushteve të tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2
Efektet financiare

Efektet financiare, që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, për vitin 2021.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 219, datë 7.4.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI I RRUGICËS
NË RRUGËN ‘BESA’, LAGJJA NR. 1
‘BARRIKADË’”, BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugicës në rrugën ‘Besa’, lagjja nr. 1 Barrikadë”, Berat.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Berat.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 79 477 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “truall”, me vlerë 79 477 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë, të përballohet nga fondet e Bashkisë Berat.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt

shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Bashkisë Berat.

8. Bashkia Berat të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Berat.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Berat, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Berat.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Berat.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat dhe Bashkia Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTTIT
“ZGJERIMI I RRUGICËS NË RRUGËN ‘BESA’, LAGJJA NR. 1 ‘BARRIKADË’”
VLERËSIMI I PASURISË SË LLOJIT “TRUALL”, ËSHTË KRYER BAZUAR NË VKM-në
NR. 89, DATË 3.2.2016

Nr.	Emër mbiemër	Lloji i pasurisë	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. e shpronësuar m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale në lekë	Adresa	Shënime
1	Ramadan Skënder Hoxha	truall	8501	5/94	7	4183	29281	Lagjja “Barrikadë”, rruga “Besa”, Berat	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Berat me shkresën nr. 5398/1 prot., datë 21.9.2018
2	Adnan Novruz Mali	truall	8501	5/95	12	4183	50196	Lagjja “Barrikadë”, rruga “Besa”, Berat	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Berat me shkresën nr. 5398/1 prot., datë 21.9.2019
VLERA TOTALE					19		79477		



VENDIM
Nr. 220, datë 7.4.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
PËR HULUMTIMET ARKEOLOGJIKE,
TË KUSHTEVE TË POSAÇME TË
LËSHIMIT TË LEJES, DOKUMENTEVE
SHOQËRUESE, SI DHE PROCEDURAVE
PËR SHQYRTIMIN OSE ANULIMIN E
LEJES PËR KRYERJEN E
HULUMTIMEVE ARKEOLOGJIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 133, pika 6, e 139, pika 3, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton dhe shtrinë fushën e veprimtimit në:

a) procedurat për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike;

b) kushtet e posaçme të lëshimit të lejes, dokumentet shoqëruese, procedurat për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike.

2. Lejet për hulumtimet arkeologjike jepen nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim, KKTKM) për:

a) projektet në rastet e zhvillimeve transformuese në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike, në tokë dhe nën ujë, sipas përcaktimit të nenit 134, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

b) projektet e rikonstruksionit të ndërtesave dhe ato të infrastrukturës në zonat arkeologjike A dhe B;

c) projektet kërkimore–shkencore në fushën e arkeologjisë.

3. Institucionet e specializuara që kryejnë veprimtari të kërkimit arkeologjik dhe subjektet e licencuara në fushën e arkeologjisë, të cilat do të kryejnë hulumtime arkeologjike në territore të njohura ose jo si zona me vlera arkeologjike, në rastet kur këto zona bien brenda territorit të zonave të mbrojtura mjedisore, respektojnë edhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

4. Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Gërmim arkeologjik” ndërhyrja e plotë në nëntokën arkeologjike. Ai kryhet sipas mënyrës frontale të avancimit, zgjerimit të sipërfaqes së gërmimit të mëparshëm ose nëpërmjet parcelimit apo copëzimit të sipërfaqes arkeologjike, të diktuar prej hapave paralelë të ndërtimit. Gërmimi arkeologjik mund të jetë me natyrë parandaluese, shpëtimi ose shkencore për një detyrë të planifikuar kërkimore–shkencore;

b) “Monitorim arkeologjik” program vëzhgimi dhe hetimi i kryer gjatë zbatimit të një projekti zhvillimor, brenda një zone të caktuar apo siti, në tokë ose nën ujë, ku ekziston mundësia që depozitimet arkeologjike mund të prishen ose të shkatërrohen. Ky proces nënkupton praninë e specialistëve arkeologë gjatë zhvillimit të punimeve të projektit deri në përfundim të gërmimeve e rezulton me përgatitjen e një raporti dhe arkivimin e të dhënave;

c) “Sondazh arkeologjik” formë testimi dhe hulumtimi e nëntokës arkeologjike të një zone të caktuar mbi tokë ose nën ujë, me qëllim marrjen e informacionit arkeologjik për një zonë të caktuar. Sondazhi në vetvete është i kufizuar në përmasat e tij me qëllim mosdëmtimin e kontekstit arkeologjik të nëntokës ose nënujit, në rast të vijimit të gërmimit arkeologjik;

ç) “Vëzhgim arkeologjik” procesi i vlerësimit të potencialit arkeologjik në një territor të caktuar nëpërmjet vrojtimit sipërfaqësor.

II. PROCEDURAT E HULUMTIMEVE ARKEOLOGJIKE

A) PROCEDURA PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË HULUMTIMEVE ARKEOLOGJIKE

1. Hulumtimet arkeologjike kryhen në tokë e nën ujë dhe përfshijnë:

a) vëzhgim arkeologjik apo vlerësim të potencialit arkeologjik;

b) monitorim arkeologjik;

c) sondazh arkeologjik;

ç) gërmim arkeologjik;

d) kërkime shkencore të reja, në vazhdim ose të përfunduara.

2. Aktiviteti arkeologjik i njoftohet Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (në vijim, IKTK) të paktën 2 (dy) ditë pune përpara fillimit.



3. Në çdo rast, aktiviteti arkeologjik shoqërohet me raportin përkatës, sipas elementeve të përcaktuara në ndarjet “B”, “C”, “Ç”, “D” dhe “DH”, të këtij kreu.

4. Hulumtimi arkeologjik realizohet sipas përcaktimit në vendimin e KKTKM-së dhe në përputhje me llojin e lejes së dhënë.

5. Institucioni i specializuar që kryen veprimtari të kërkimit arkeologjik ose subjekti i licencuar në fushën e arkeologjisë, i pajisur me leje për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike nga KKTKM-ja, informon sekretarinë teknike të IKTK-së për ecurinë e hulumtimit arkeologjik, në përputhje me kushtet e përcaktuara në aktmarrëveshjen përkatëse.

6. Raporti përfundimtar i monitorimit arkeologjik, i sondazhit arkeologjik dhe i gërmimit arkeologjik dorëzohet pranë sekretarisë teknike të IKTK-së. Në rastin e sondazhit arkeologjik dhe të gërmimit arkeologjik, IKTK-ja prezanton konkluzionet paraprake apo përfundimtare në KKTKM.

7. Gjatë kryerjes së hulumtimeve arkeologjike, stafi i përfshirë nuk ndryshohet, me përjashtim të shkaqeve të përligjura, të cilat i raportohen menjëherë KKTKM-së.

8. Kur subjekti përfundon hulumtimin arkeologjik të përcaktuar në vendimin e KKTKM-së, njofton sekretarinë teknike të IKTK-së. Sekretaria teknike e kalon çështjen në KKTKM për veprime të mëtejshme.

9. Financimi i veprimtarisë së hulumtimeve arkeologjike parandaluese dhe të shpëtimit sigurohet drejtpërdrejt nga investitori në masën 100%. Këto veprimtari përfshijnë:

- a) sondazhet arkeologjike;
- b) gërmimin arkeologjik;
- c) monitorimin arkeologjik;
- ç) konservimin e gjetjeve arkeologjike;
- d) administrimin arkeologjik;

dh) përpilimin e dokumentacionit të nxjerrë nga hulumtimi arkeologjik;

e) përgatitjen e raporteve paraprake dhe përfundimtare;

ë) botimin e rezultateve të hulumtimit arkeologjik.

10. Në çdo rast, subjektet e pajisura me leje për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike nga KKTKM-ja ngarkojnë në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania* rezultatet e hulumtimeve

arkeologjike, sipas fazave dhe afateve kohore të përcaktuara në vendimin e KKTKM-së.

B) VËZHGIM ARKEOLOGJIK APO VLERËSIM I POTENCIALIT ARKEOLOGJIK

1. Raporti i vëzhgimit arkeologjik përmban:

- a) të dhëna për zonën e vëzhguar;
- b) të dhëna për projektin;
- c) hapësirën e vëzhguar;
- ç) metodologjinë e ndjekur për vëzhgimin arkeologjik sipërfaqësor;
- d) rezultatet e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor;
- dh) paraqitjen e përmbledhur të potencialit arkeologjik të zonës;
- e) rekomandime.

2. Të dhënat për zonën e vëzhguar përfshijnë informacionin për pozicionin gjeografik dhe karakteristikat gjeomorfologjike të zonës së vëzhguar, si më poshtë vijon:

a) përshkrimin gjeografik, i cili përfshin një përmbledhje të shkurtër për të dhënat gjeografike dhe të karakteristikave gjeomorfologjike të zonës ku parashikohet të shtrihet projekti, si: topografia, gjeologjia burime natyrore, biodiversiteti;

b) materialet fotografike të realizuara gjatë kryerjes së proceseve arkeologjike në terren;

c) planvendosjen e zonës ku zhvillohet projekti, me koordinata gjeografike sipas Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH);

ç) njollën e projektit zhvillimor në formatin *.cad*, *.dwg*, *.arxmap*, *.mxd*.

3. Të dhënat për projektin përfshijnë elementet teknike të projektit zhvillimor, si më poshtë:

a) përshkrimi i projektit zhvillimor me të dhënat kryesore teknike të tij ose përshkrimi i projektit kërkimor-shkencor me të dhënat shkencore;

b) gjendja aktuale e territorit, ku të specifikohet nëse është ndërhyrë në të apo jo, për sa i takon projektin, shoqëruar edhe me foto nga terreni.

4. Gjatë kryerjes së vëzhgimit arkeologjik në terren, institucioni i specializuar që kryen veprimtari të kërkimit arkeologjik ose subjekti i licencuar në fushën e arkeologjisë përshkruan gjurmën ku shtrihet projekti, zonën përreth, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor që do të kryhet në funksion të infrastrukturës ndihmëse për projektin përkatës. Veprimtaria në terren dokumentohet me foto, skica dhe skeda.

5. Hapësira e vëzhguar përfshin:

- a) gjurmën ku shtrihet projekti;



b) territorin përreth;

c) infrastrukturën ndihmëse të projektit, në rastin e projekteve zhvillimore, ku futen: rrugët e aksesit, karrierat ose lidhja me sistemin elektroenergjetik në rastin e projekteve të HEC-ve;

ç) zonat në të cilat nuk u krye vëzhgimi arkeologjik bashkë me arsyet përkatëse.

6. Procesi shoqërohet me mbajtjen e skedave të vëzhgimit arkeologjik (*survey*), të cilat pasqyrohen dhe gjatë hartimit të raportit. Format i origjinal, një kopje e këtyre skedave, si dhe formati elektronik (*file maker*) dorëzohen pranë IKTK-së.

7. Përshkrimi i hapësirës së vëzhguar shoqërohet me paraqitjen grafike të procesit të kryer, ku përfshihen:

a) zona e vëzhguar, e ndarë në trakte, pasqyruar në planvendosje me koordinatat përkatëse dhe e mbivendosur në hartë topografike ose ortofoto në formatin *.cad*, *.dwg*, *.arcmap*, *.mxd*;

b) foto nga traktet e vëzhguara;

c) arkeologët gjatë kryerjes së vëzhgimit.

8. Metodologjia e ndjekur për vëzhgimin arkeologjik sipërfaqësor tregon procesin e kryerjes së vëzhgimit arkeologjik dhe përzgjidhet nga drejtuesi i projektit bazuar në karakteristikat e sipërfaqes që do të vëzhgohet, numrin eurvejuesve në grupin e punës, detyrat e tyre dhe mjetet e punës që do të përdoren në terren.

9. Të dhënat për metodologjinë përfshijnë:

a) metodën e ndjekur për realizimin e vëzhgimit sipërfaqësor arkeologjik nga fillimi i procesit deri në përfundim të tij;

b) mjetet e punës të përdorura për dokumentimin e procesit;

c) grupin e punës të përfshirë në këtë proces dhe detyrat e tyre;

ç) paraqitjen teknike, ku futen:

i. foto ilustruese nga puna në terren dhe metodologjia e ndjekur nga arkeologët;

ii. pikat e marra me GPS në terren, të pasqyruara në hartë në formatin *.cad*, *.dwg*, *.arcmap*, *.mxd*.

10. Rezultati i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor nxjerr përfundime, bazuar në interpretimin e gjetjeve e të konstatimeve të bëra në terren, dhe përfshin:

a) përfundimet e nxjerra nga realizimi i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor:

i. interpretimi i gjetjeve;

ii. paraqitja e gjetjeve me foto;

b) në rastet kur në sipërfaqe nuk janë evidentuar gjetje arkeologjike, argumentimin e mungesës së tyre.

11. Paraqitja e potencialit arkeologjik të zonës përfshin:

a) informacion të përmbledhur, të nxjerrë nga bibliografia e konsultuar për çdo rast;

b) listën e pasurive kulturore të deklaruara;

c) të dhëna për toponiminë e zonës.

12. Çdo raport përfshin rekomandimet për vijimësinë e procesit të shqyrtimit të projektit zhvillimor bazuar në rezultatet e nxjerra nga vëzhgimi arkeologjik sipërfaqësor.

13. Bazuar në rezultatet e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor apo të vlerësimit të potencialit arkeologjik të zonës, subjekti i pajisur me leje për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike i propozon KKTKM-së:

a) kryerjen e sondazheve arkeologjike deri në 15 (pesëmbëdhjetë) % të sipërfaqes, aty ku gjatë vëzhgimit arkeologjik është lokalizuar prania e substancës arkeologjike, ose aty ku ka të dhëna arkivore të sigurta;

b) pikat ku do të kryhen këto sondazhe dhe dimensionet në gjerësi x gjatësi x thellësi;

c) kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit, duke përcaktuar hapësirën ku do të kryhet ky gërmim;

ç) mbikëqyrjen arkeologjike për pika të veçanta të konsideruara me potencial apo intensitet të lartë gjetjesh arkeologjike;

d) mbikëqyrjen periodike arkeologjike gjatë zbatimit të punimeve.

14. Çdo raport përfshin bibliografinë e konsultuar, ku përfshihen titujt e materialeve shkencore të fushave të ndryshme, të cilat janë përdorur për studimin e zonës dhe të materialit arkeologjik.

15. Raporti i vëzhgimit arkeologjik shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) fotot, të cilat, në të gjitha rastet kur përdoren gjatë raportit, shoqërohen me dicitura;

b) raportin e plotë dhe përmbledhës, prezantimi në *Power-Point* i raportit.

16. KKTKM-ja, pas shqyrtimit të raportit të vëzhgimeve arkeologjike sipërfaqësore dhe nënujore, vendos për kryerjen e monitorimit arkeologjik gjatë zbatimit të projekteve transformuese në territor. Rregullimi i marrëdhënieve juridike ndërmjet palëve, për



monitorimin arkeologjik gjatë zbatimit të projektit, realizohet nëpërmjet lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse ndërmjet palëve: IKTK–subjekt i licencuar–investitor.

C) MONITORIMI ARKEOLOGJIK

Raporti i monitorimit arkeologjik përmban:

a) paraqitjen e projektit, emërtimin, shkahun, llojin e ndërhyrjes dhe qëllimin e tij;

b) përshkrimin me të dhënat teknike të vendit ku zhvillohet projekti, të sipërfaqes dhe të thellësisë, i cili përmban:

i. koordinata në planvendosjen e përgjithshme të projektit, të segmentit të realizuar në periudhën 30-ditore për të cilën raportohet;

ii. foto të realizuara gjatë punës në terren;

iii. metodologjinë e ndjekur;

iv. gjetjet arkeologjike të evidentuara gjatë procesit të gërmimit, koordinatat në GPS të vendndodhjes, përshkrimin dhe rëndësinë e gjetjes, përmasat e përlogaritura, rekomandime, si dhe masat e përkohshme mbrojtëse që janë marrë deri në mbajtjen e procesverbalit të përbashkët me mbikëqyrësin;

v. renditjen e të dhënave arkivore, vlerësimin e hartave të vjetra dhe të atyre të reja, foto ajrore, të dhëna për ndërhyrjet e mëparshme në sipërfaqen e gërmimit, informacione për ndryshimet natyrore të shekujve të kaluar për historinë e saj, botimet e ndryshme.

Ç) SONDAZHET ARKEOLOGJIKE

1. Sondazhet arkeologjike kryhen në rastet e projekteve kërkimore–shkencore ose të projekteve zhvillimore nga institucione të specializuara që kryejnë veprimtari të kërkimit arkeologjik dhe subjektet e licencuara në fushën e arkeologjisë.

2. Raporti i sondazheve arkeologjike përmban:

a) paraqitjen e projektit, emërtimin, shkahun, llojin e ndërhyrjes dhe qëllimin e tij;

b) përshkrimin me të dhënat teknike të vendit, ku do të kryhet operacioni ose sondazhi arkeologjik, të sipërfaqes dhe të thellësisë;

c) situatën topografike, njoftimet për përmbajtjen e tokës dhe përdorimin aktual të sipërfaqes, ku do të kryhet operacioni ose sondazhi arkeologjik;

ç) renditjen e të dhënave arkivore, vlerësimin e hartave të vjetra dhe të atyre të reja, foto ajrore, të dhëna për ndërhyrjet e mëparshme në sipërfaqen e gërmimit, informacione për ndryshimet natyrore të

shekujve të kaluar për historinë e saj, botimet e ndryshme;

d) përcaktimin e pritshmërisë shkencore;

dh) paraqitjen e të dhënave për zonat sipërfaqësore dhe në thellësi, për të cilat ka informacion se janë dëmtuar, si p.sh.: ndërtimet e kohëve moderne, bodrumet e thella, ndërtime infrastrukturore si kanalizime.

D) GËRMIMI ARKEOLOGJIK

Gërmimi arkeologjik paraprihet nga koncepti i gërmimit arkeologjik, i cili përmban:

a) paraqitjen e projektit, emërtimin, shkahun, llojin e ndërhyrjes dhe qëllimin e tij;

b) përshkrimin me të dhënat teknike të vendit ku do të kryhet operacioni ose gërmimi arkeologjik, të sipërfaqes dhe të thellësisë;

c) situatat topografike, njoftimet për përmbajtjen e tokës dhe përdorimin aktual të sipërfaqes, ku do të kryhet operacioni ose gërmimi arkeologjik;

ç) renditjen e të dhënave arkivore, vlerësimin e hartave të vjetra dhe të atyre të reja, foto ajrore, të dhëna për ndërhyrjet e mëparshme në sipërfaqen e gërmimit, informacione për ndryshimet natyrore të shekujve të kaluar për historinë e saj, botimet e ndryshme, përcaktimin e pritshmërisë shkencore;

dh) paraqitjen e të dhënave për zonat sipërfaqësore dhe në thellësi, për të cilat ka informacion se janë dëmtuar, si p.sh.: ndërtimet e kohëve moderne, bodrumet e thella, ndërtime infrastrukturore si kanalizime.

DH) PROJEKTET KËRKIMORE-SHKENCORE TË REJA, NË VAZHDIM OSE TË PËRFUNDUARA

1. Projektet kërkimore-shkencore të reja përmbajnë:

a) kërkesën për miratim projekti kërkimor-shkencor, firmosur nga përfaqësuesi i institucionit të specializuar që kryen veprimtari të kërkimit arkeologjik, shoqëruar me dokumentacionin për çdo projekt të ri;

b) marrëveshjen e bashkëpunimit me institucionet e huaja, ku pjesë e aneksit të saj të jetë akti me të cilin është përcaktuar përfaqësuesi i institucionit të huaj dhe i atij shqiptar, firmosur dhe vulosur nga organi që ka nxjerrë aktin, origjinale ose fotokopje e njëzuar me origjinalin;

c) planin e përgjithshëm me koordinatat gjeografike në një nga sistemet e mëposhtme të koordinatave:



- i. *Albanian 1987, EPSG:4191*;
- ii. *Albanian 1987/Gauss-Kruger zone 4, EPSG: 2462*;
- iii. WGS 84, EPSG: 4326;
- iv. WGS 84/UTM zone 34N, EPSG: 32634;
- v. KRRGJSH 2010 (ETRS89/*Albania* TM 2010), EPSG: 6870.

c) koordinatat e zonës ku do të kryhet ndërhyrja ose procesi arkeologjik;

d) përshkrimin me të dhënat teknike të vendit, ku do të kryhet operacioni, të sipërfaqes dhe të thellësisë;

dh) renditjen e të dhënave arkivore, vlerësimin e hartave të vjetra dhe të atyre të reja, foto ajrore, të dhëna për ndërhyrjet e mëparshme në sipërfaqen e gërmimit, informacione;

e) për ndryshimet natyrore të shekujve të kaluar për historinë e saj, botimet e ndryshme;

ë) përcaktimin e pritshmërisë shkencore;

f) informacionin për institucionin/institucionet financuese të projektit;

g) periudhën kohore kur do të realizohet projekti shkencor, për vitin kur aplikohet;

gj) në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, përcaktohen masat për rehabilitimin e zonës;

h) përcaktimin e venddepozitimit të gjetjeve arkeologjike, shoqëruar nga lista e gjetjeve. Një kopje e listës së gjetjeve dorëzohet pranë IKTK-së dhe IKRTK-së.

i) prezantimin në *Power-Point* të projektit, ku të specifikohen qartë:

- i. gjurma në plan;
- ii. foto të zonës;
- iii. ndërhyrjet e mëparshme në këtë zonë, nëse ka pasur;
- iv. gjendja aktuale;
- v. objektivat që synon projekti ose foto të objekteve që do të studiohen.

2. Projektet kërkimore-shkencore në vazhdim përmbajnë:

a) kërkesën për miratim projekti kërkimor-shkencor, firmosur nga përfaqësuesi i institucionit të specializuar që kryen veprimtari të kërkimit arkeologjik, shoqëruar me dokumentacionin për çdo projekt të ri;

b) marrëveshjen e bashkëpunimit me institucionet e huaja, ku pjesë e aneksit të saj të jetë

akti me të cilin është përcaktuar përfaqësuesi i institucionit të huaj dhe i atij shqiptar, firmosur dhe vulosur nga organi që ka nxjerrë aktin, origjinale ose fotokopje e njësuar me origjinalin;

c) planin e përgjithshëm me koordinatat gjeografike në një nga sistemet e mëposhtme të koordinatave:

- i. *Albanian 1987, EPSG:4191*;
- ii. *Albanian 1987/Gauss-Kruger zone 4, EPSG: 2462*;
- iii. WGS 84, EPSG: 4326;
- iv. WGS 84/UTM zone 34N, EPSG: 32634;
- v. KRRGJSH 2010 (ETRS89/*Albania* TM 2010), EPSG: 6870.

c) koordinatat e zonës ku do të kryhet ndërhyrja ose procesi arkeologjik;

d) emërtimin e projektit, shkakun, llojin e ndërhyrjes dhe qëllimin e tij; emërtimi i projektit duhet të jetë i pandryshueshëm gjatë gjithë vazhdimësisë së tij;

dh) përshkrimin me të dhënat teknike të vendit, ku do të kryhet operacioni, të sipërfaqes dhe thellësisë;

e) përcaktimin e pritshmërisë shkencore;

ë) përcaktimin e venddepozitimit të gjetjeve arkeologjike, shoqëruar nga lista e gjetjeve. Një kopje e listës së gjetjeve dorëzohet pranë IKTK-së dhe IKRTK-së;

f) drejtuesin/bashkëdrejtuesit shkencorë të projektit, të cilët nuk ndryshohen përveçse për arsye objektive të përligjura, të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e funksionit. Çdo ndryshim i burimeve njerëzore lidhur me projektin i raportohet menjëherë KKTKM-së;

g) informacionin për institucionin/institucionet financuese të projektit;

gj) periudhën kohore kur do të realizohet projekti shkencor, për vitin kur aplikohet;

h) relacionin e rezultateve të projektit kërkimor-shkencor për vitin paraardhës;

i) prezantimin në *Power-Point* të projektit, ku të specifikohen qartë:

- i. gjurma në plan;
- ii. foto të zonës;
- iii. ndërhyrjet e mëparshme në këtë zonë, nëse ka pasur;
- iv. gjendja aktuale;
- v. objektivat që synon projekti ose foto të objekteve që do të studiohen.



3. Projektet kërkimore-shkencore të përfunduara përmbajnë:

a) raportin përfundimtar me rezultatet shkencore të firmosura nga drejtuesi/bashkëdrejtuesit shkencorë;

b) listat dhe katalogun e njësive arkeologjike;

c) hartat në ortofoto 2015/2007 apo topografike me shkallë 1:10000/1:25000, ku të jenë hedhur zonat e projektit kërkimor-shkencor të përfunduar, pjesë e raportit apo studimit arkeologjik të ngarkuar në bazën e të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë, printuar nga sistemi;

ç) prezantimin në *Power-Point* të projektit të përfunduar, ku të specifikohen qartë:

i. zonat objekt studimi në hartën ortofoto;

ii. foto të zonës;

iii. ndërhyrjet e mëparshme në këtë zonë, nëse ka pasur;

iv. gjendja aktuale;

v. objektivat e arritura të projektit ose foto të objekteve, për mbledhjen e KKTKM-së.

4. Plan i përgjithshëm, parashikuar në shkronjën “c”, të pikës 1, dhe në shkronjën c, të pikës 2, të ndarjes “DH”, të këtij kreu, dorëzohet në një nga formatet vektoriale në të cilin është përpunuar, si: *.dmg*, *.dxf*, *.shp*. Në rastin kur projekti është hartuar në programe GIS, bashkë me formatin *.shp* dorëzohen edhe skedarët e projekteve, emërtimi i projektit, shkaku, lloji i ndërhyrjes dhe qëllimi i tij. Emërtimi i projektit duhet të jetë i pandryshueshëm gjatë gjithë vazhdimësisë së tij.

5. Çdo projekt bashkë me dokumentacionin shoqërues duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose të njësuara me origjinalin.

6. Dokumentacioni i përshkruar në ndarjen “DH”, të këtij kreu, ngarkohet në bazën e të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë.

III. KUSHTET E POSAÇME TË LËSHIMIT TË LEJES, DOKUMENTET SHOQËRUESE, PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN OSE ANULIMIN E LEJES PËR KRYERJEN E HULUMTIMEVE ARKEOLOGJIKE

A) KUSHTET E POSAÇME TË LËSHIMIT TË LEJES

Leja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike u jepet subjekteve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 140 e 158, të ligjit nr. 27/2018, “Për

trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe kushtet e posaçme, si më poshtë vijon:

a) në rastet e kërkimeve shkencore, të reja ose në vazhdim, të disponojë miratimin e këshillit teknik, këshillit shkencor ose të bordit apo departamentit përgjegjës të institucionit të specializuar që kryen veprimtari të kërkimit arkeologjik;

b) në rastet kur hulumtimi arkeologjik kërkohet të kryhet nga dy ose më shumë subjekte dhe/ose në bashkëpunim me partner të huaj, të disponojnë marrëveshjen e bashkëpunimit;

c) në rastet e vëzhgimit arkeologjik, të disponojë një grup pune në terren, në të cilin përfshihen të paktën tre arkeologë, ku emrat dhe funksionet e tyre vendosen në raport;

ç) në rastet e monitorimit arkeologjik, të disponojë një grup pune, ku përfshihen:

i. drejtuesi teknik/projekti;

ii. arkeologë në përputhje me natyrën e projektit.

d) Në rastet e sondazhit dhe të gërmimit arkeologjik, të disponojë një grup pune, ku përfshihen:

i. drejtues projekti;

ii. arkeologë në përputhje me natyrën e projektit;

iii. staf për përpunimin e gjetjeve;

iv. specialist konservues;

v. specialist qeramike, monedhash, metalesh, objekteve qelqi;

vi. skicograf;

vii. ekspertë, të cilët do të bëjnë të mundur realizimin e plotë të një projekti nga fillimi deri në fazën e fundit të tij.

B) DOKUMENTE SHOQËRUESE PËR PAJISJEN ME LEJE PËR KRYERJEN E HULUMTIMEVE ARKEOLOGJIKE

Dokumentacioni për pajisjen me leje për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike përfshin:

a) kërkesën për pajisje me leje, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dokumentin për regjistrimin e subjektit juridik, të lëshuar nga organi ose institucioni shtetëror i ngarkuar me ligj;

c) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);

ç) emrin e administratorit të personit juridik ose të subjektit të personit fizik/tregtar, si dhe të



drejtuesit teknik të subjektit të licencuar në fushën e arkeologjisë;

d) projektin e hulumtimit arkeologjik që do të kryejë.

C) PROCEDURA PËR SHQYRTIMIN OSE ANULIMIN E LEJES PËR HULUMTIME ARKEOLOGJIKE

1. Kërkesa për lëshimin e lejes dhe dokumentet shoqëruese të saj dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari arkeologjike dhe veprimtari arkeologjike nënujore, me kodin VI.3, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

2. Kërkesa administrohet nga sporteli unik dhe sekretaria teknike e KKTKM-së, pranë IKTK-së.

3. Dokumentet për lëshimin e lejes, që ngarkohen në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, duhet të jenë:

a) origjinale ose kopje të njësuara me origjinalin;

b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë dhe të njësuara me origjinalin nga noterit;

c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter), vërtetuar ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit.

4. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues, të paraqitura nga subjektet e interesuara për t'u pajisur me leje për hulumtime arkeologjike kalon për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM.

5. Procedura e administrimit të kërkesës dhe e shqyrtimit të saj deri në vendimmarrje me miratim ose jo të kërkesës realizohet sipas rregullave të funksionimit të KKTKM-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

6. Ndaj vendimit të KKTKM-së mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

7. Sekretaria teknike bën shpërndarjen e lejeve të të interesuarve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit, nëpërmjet shërbimit postar, ose lejet tërhiqen nga përfaqësuesi ligjor apo nga persona të autorizuar me akt noterial për të kryer një veprim të tillë apo personat e autorizuar nga personi juridik. Kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet.

8. Për pajisjen me leje për kryerjen e sondazheve ose të gërmimeve arkeologjike, fillimisht miratohet në KKTKM koncepti i sondazheve ose i gërmimeve.

9. Në çdo rast, subjektet e pajisura me leje për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike ngarkojnë në portalin unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania* rezultatet e hulumtimeve arkeologjike sipas fazave dhe afateve kohore të përcaktuara në vendimin e KKTKM-së.

10. Me përfundimin e hulumtimit arkeologjik, leja konsiderohet e ezauruar.

Ç) ANULIMI I LEJES

1. Leja për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike anulohet me vendim të KKTKM-së në rastet e parashikuara në nenet 141 dhe 158, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".

2. Për çdo rast të konstatuar të mosplotësimit të kriterëve apo të shkeljes së detyrimeve të lejes, IKTK-ja harton një raport vlerësimi të fakteve dhe ia kalon për shqyrtim KKTKM-së.

3. KKTKM-ja urdhëron menjëherë subjektin e pajisur me leje për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike për ripërmblidhjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda afatit 15-ditor, duke pezulluar lejen.

4. Në rast se brenda afatit të caktuar kriteret nuk përmblidhen ose nuk bëhet ndreqja e detyrimeve të shkelura, bëhet anulimi i lejes.

5. Ndaj vendimit për anulimin e lejes mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

D) REGJISTRIMI DHE PUBLIKIMI I LEJES

1. IKTK-ja, nëpërmjet sekretarisë teknike, mban e ruan sipas rregullave në fuqi:

a) protokoll për evidentimin e kërkesave të subjekteve për leje;

b) regjistrin kombëtar të lejeve për ndërhyrjet në pasuritë kulturore arkeologjike.

2. Leja e miratuar për veprimtarinë e hulumtimit arkeologjik, çdo vendim anulimi apo vendim tjetër lidhur me këto leje, duhet të publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Të gjitha subjektet, të cilat kanë paraqitur kërkesë për leje për kryerjen e hulumtimeve



arkeologjike dhe nuk janë shqyrtuar nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të dorëzojnë dokumentacionin plotësues për të provuar plotësimin e kushteve sipas këtij vendimi, brenda 3 (tre) muajve nga miratimi i këtij vendimi.

2. Të gjitha kërkesat për leje për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike dhe dokumentacioni shoqërues të dërgohen në formë fizike nëpërmjet shërbimit postar pranë sportelit unik/sekretarisë teknike të IKTK-së deri në kalimin e të gjithë procedurës në portalin unik të shërbimeve qeveritare e-Albania.

3. IKTK-ja njofton Agjencinë Shtetërore të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për çdo

ndryshim që mund të ketë në të dhënat parësore të databazës shtetërore të regjistruar “Databaza gjeografike për regjistrimin e aktivitetit në terren të Drejtorisë së Shërbimeve Arkeologjike”.

4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

FORMULAR KËRKESE

Kërkesë për pajisjen me leje për hulumtime arkeologjike/ vëzhgim arkeologjik/ sondazh arkeologjik/ gërmim arkeologjik/ monitorim arkeologjik

Institucioni përgjegjës:

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

1. APLIKUESI

STATUSI I APLIKUESIT

INSTITUCION

PERSON FIZIK

PERSON JURIDIK

2. INFORMACION SPECIFIK (NË RASTIN KUR APLIKUESI ËSHTË PERSON FIZIK/PERSON JURIDIK)

Emri i subjektit/institucionit:

NIPT:

Administratori:

Emri

Mbiemri

ID administratori:

Nr. tel/cel:

E-mail:

Adresa:

3. INFORMACION SPECIFIK MBI DREJTUESIN TEKNIK (NË RASTIN KUR APLIKUESI ËSHTË PERSON JURIDIK)

Drejtuesi teknik (DT):

Emri

Mbiemri

Tel

Nr. i licencës së DT:

4. INFORMACION SPECIFIK MBI LLOJIN E LEJES SË KËRKUAR PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK

Projektin e hulumtimit arkeologjik për të cilën kërkohet leja:	Vëzhgim arkeologjik sipërfaqësor/nënujor			
	Sondazhe arkeologjike nëntokësore/nënujore			
	Gërmime arkeologjike nëntokësore/nënujore			
	Monitorim arkeologjik nëntokësore/nënujore			



	Vendi i kryerjes së veprimtarisë për të cilin kërkohet leja përkatëse								
5. DOKUMENTACIONI I NGARKUAR									
1. Licenca personale, nëse është individ, ose licenca e shoqërisë									
2. Projektin/propozimin e hulumtimit arkeologjik që do të kryhet (*miratimin e këshillit teknik, këshillit shkencor, ose të bordit apo departamentit përgjegjës, në rastin e institucionit të specializuar që kryen veprimtari të kërkimit arkeologjik)									
6. BAZA LIGJORE E KËRKESËS									
1. Ligji nr. 27/2018, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”									
2. Vendim nr. ___, datë ___.2021 i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shqyrtuese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike”									
7. NJOFTIMI									
Marrja e informacionit:		Postë		E-mail		E-albania		Dorazi	
E-mail (për njoftimin):									
Afati i njoftimit:	Jo më vonë se 10 ditë nga vendimi i KKTKM-së								

VENDIM
Nr. 222, datë 7.4.2021

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
SUBSTANCave KANDIDATE^{*1}**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së substancave candidate, sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi, substancat e rrezikshme të së cilës janë candidate për t’u futur në listën e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë për shëndetin e njeriut dhe mjedisin (lista SVHC).

2. Lista përditësohet bazuar në listën e rishikuar të substancave candidate të Bashkimit Evropian.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet në varësi të tyre për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas një viti nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

^{*1}“Listë candidate” është lista e substancave që janë duke u konsideruar/shqyrtuar për t’u bërë pjesë e listës SVHC, si substanca kimike me rrezikshmëri shumë të lartë, të cilat mund të shkaktojnë efekte serioze për njerëzit apo mjedisin (psh.: substanca kancerogjene, mutagjene, toksike për riprodhimin te njerëzit, substanca që janë të qëndrueshme, të bioakumulueshme, toksike).



NUMRI RENDOR	EMRI I SUBSTANCËS	PËRSHKRIMI	NR. EC	NR. CAS	ARSYET E PËRSHIRJES	DATA E PËRSHIRJES SË SUBSTANCËS NË KËTË LISTË
1.	Dioktilitin dilaurate, stanane, dioktil-, bis(koko akiloksi) derivatet, dhe stanane te tjera dioktil-, derivaet e bis(akilokse yndyrore) ku C12 është numri i karbonit mbizotërues në pjesën e akiloksisë yndyrore <i>(Diocetyl dilaurate, stannane, dioctyl-, bis(coco acyloxy) derivs., and any other stannane, dioctyl-, bis(fatty acyloxy) derivs. wherein C12 is the predominant carbon number of the fatty acyloxy moiety)</i>		-	-	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
	dioktilitin dilaurate; derivatet e stanane, dioktil-, bis (koko akiloksi) <i>(dioctyl dilaurate; stannane, dioctyl-, bis(coco acyloxy) derivs)</i>		-	-		
	Dioktilitin dilaurate <i>(Diocetyl dilaurate)</i>		222-883-3	3648-18-8		
	Derivatet (Stanane, dioktil-, bis (koko akiloksi).) <i>(Stannane, dioctyl-, bis(coco acyloxy) derivs.)</i>		293-901-5			
2.	Bis (2-(2-metoksietoksi)etil)eter <i>Bis(2-(2-methoxyethoxy)ethyl)ether</i>		205-597-7	91648-39-4	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
3.	Dibutylbis(pentane-2,4-dionato-O,O') kallaj <i>(Dibutylbis(pentane-2,4-dionato-O,O')tin)</i>		245-152-0	143-24-8	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
4.	Butil 4-hidroksibenzoate <i>(Butyl 4-hydroxybenzoate)</i>		202-318-7	22673-19-4	Substanca që mund të shkaktojë çrregullime endokrine; (Neni 20, pika 4,	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



						germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
5.	2-metilimidazole (2-methylimidazole)	211-765-7	693-98-1			Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
127.	Acid 1,2-Benzenedikarboksilik, esteret e dipentilit, degezuar dhe linear) (1,2-Benzenedicarboxylic acid dipentyl ester, branched and linear)		284-032-2	84777-06-0	Toksike për riprodhimin te njërëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
128.	α,α -Bis[4-(dimetilamino)fenil]-4 (fenilamino)naftalene-1-metanol (C.I. Tretes Blue 4) (α,α -Bis[4-(dimethylamino)phenyl]-4 (phenylamino)naphthalene-1-methanol (C.I. Solvent Blue 4))	me $\geq$ 0,1% e ketone Michler (EC Nr. 202-027-5) ose bazes Michler (EC Nr. 202-959-2)	229-851-8	6786-83-0	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
129.	N,N,N',N'-tetrametil-4,4'- metilenedianiline (baza Michler) (N,N,N',N'-tetramethyl-4,4'- methylenedianiline (Michler's base))		202-959-2	101-61-1	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



130.	Plumb(II) bis(metansulfonati) (<i>Lead(II) bis(methanesulfonate)</i>)	-		401-750-5	17570-76-2	Toksike për riprodhimin te njërëzit, kategorië 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
131.	Formamid (<i>Formamide</i>)			200-842-0	75-12-7	Toksike për riprodhimin te njërëzit, kategorië 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
132.	triksidi Diboroni (<i>Diboron trioxide</i>)			215-125-8	1303-86-2	Toksike për riprodhimin te njërëzit, kategorië 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
133.	4 - [[4-amilino-1-naftil] [4- (dimetilamino) fenil] metilen] cikloheksa-2,5-dien-1-iliden] klori i dimetilamonit (C.I. Blu Blu 26 [4-[[4-amilino-1-naftil] [4- (dimetilamino)fenil]metylene]cycl ohexa-2,5-dien-1-ylidene] dimethylammonium chloride (C.I. Basic Blue 26)	me ≥ 0.1% te ketone Michler (EC Nr. 202-027-5) ose bazes Michler (EC Nr. 202-959-2)		219-943-6	2580-56-5	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
134.	[4- [4,4'-bis (dimetilamin) benzidriliden] cikloheksa-2,5-dien-1- iliden] klorid dimetilamoni (C.I. baze vjollce 3) [4-[4,4'-bis(dimethylamino) benzylidene]cyclohexa-2,5-dien-1- ylidene]dimethylammonium chloride (C.I. Basic Violet 3)	me ≥ 0.1% te ketone Michler (EC Nr. 202-027-5) ose bazes Michler (EC Nr. 202-959-2)		208-953-6	548-62-9	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
135.	4,4'-bis(dimetilamino)benzofenone (Michler ketone)			202-027-5	90-94-8	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a),	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



	<i>(4,4'-bis(dimethylamino)benzophenone</i> (<i>Michler's ketone</i>))					e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
136.	Alkool i 4,4'-bis(dimetilamin)-4"- (metilamin)tritol (4,4'-bis(dimethylamino)-4"- (methylamino)trityl alcohol)	me ≥ 0.1% te ketone Michler (EC Nr. 202-027-5) ose bazes Michler (EC Nr. 202-959-2)	209-218-2	561-41-1		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
137.	1,3,5-tris[(2S dhe 2R)-2,3- epoksiopropil]-1,3,5-triazine-2,4,6- (1H,3H,5H)-trione (β-TGIC)) (1,3,5-tris[(2S and 2R)-2,3- epoxypropyl]-1,3,5-triazine-2,4,6- (1H,3H,5H)-trione (β-TGIC))	-	423-400-0	59653-74-6		Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
138.	1,3,5-Tris(oksiran-2-ilmetil)-1,3,5- triazinane-2,4,6-trione (TGIC)) (1,3,5-Tris(oxiran-2-ylmethyl)-1,3,5- triazinane-2,4,6-trione (TGIC))		219-514-3	2451-02-9		Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
139.	1,2-bis(2-metoksietoksi)etani (TEGDME; triglime)) (1,2-bis(2-methoxyethoxy)ethane (TEGDME; triglyme))		203-977-3	112-49-2		Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
140.	(1, 2-dimetoksietane; etilene glikol dimetil eteri (EGDME)) (1, 2-dimethoxyethane; ethylene glycol dimethyl ether (EGDME))		203-794-9	110-71-4		Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
141.	Fibra Qeramike Refraktare Aluminosilikate të Zirkonit (<i>Zirconia Aluminosilicate Refractory</i> <i>Ceramic Fibres</i>)	janë fibra të mbuluara nga numri i indeksit 650-017-00-8 në Shtojcën VI, pjesa 3, tabela 3.1 e legjislacionit që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, dhe plotësojnë tre kushtet e mëposhtme: a) Oksidet e aluminit, silicit dhe zirkonit janë përberësit kryesorë të pranishëm (në	-	-		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



					fibra) brenda intervalit të përcendimit të ndryshueshëm b) fibrat kanë një diametër mesatar gjeometrik të përcaktuar të gjatësisë, më pak se dy gabime standarde gjeometrike prej 6 ose më pak mikrometra (µm) c) përmbajtja e oksidit alumin dhe oksideve alkaline tokësore (Na ₂ O + K ₂ O + CaO + MgO + BaO) është më pak ose e barabartë me 18% të peshës		604-314-4	142844-00-6		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve") #Toksike për riprodhimin të njëzërit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
142.	Fibra Qeramike Refraktare të Aluminosilikateve (<i>Aluminosilicate refractory ceramic fibres</i>)						222-979-5	3687-31-8			
143.	Darsenati i triplumbit (<i>Trilead diarsenate</i>)						234-329-8	11103-86-9		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
144.	Hidroksioktaoksodizinkatdikromat kaliumi (<i>Potassium hydroxyoctaoxodizincatedichromate</i>)						201-004-7	77-09-8		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
145.	Fenoltalein (<i>Phenolphthalein</i>)						256-418-0	49663-84-5		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Për menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



					e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
146.	N,N-dimetilacetamidi (<i>N,N-dimethylacetamide</i>)	204-826-4	127-19-5		Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
147.	Stufnat plumbi (<i>Lead staphnate</i>)	239-290-0	15245-44-0		Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
148.	Dipikrat plumbi (<i>Lead dipicrate</i>)	229-335-2	6477-64-1		Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
149.	Diazid plumbi, azide plumbi (<i>Lead diazide, Lead azide</i>)	236-542-1	13424-46-9		Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
150.	Formaldehide, produkte reaksioni oligomerike me aniline (<i>Formaldehyde, oligomeric reaction products with aniline</i>)	500-036-1	25214-70-4		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
151.	dikromium tris(kromati) (<i>Dichromium tris(chromate)</i>)	246-356-2	24613-89-6		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
152.	Arsenat Kalciumi (<i>Calcium arsenate</i>)	231-904-5	7778-44-1		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



153.	Fitilatet e Bis(2-metoksietiliti) (<i>Bis(2-methoxyethyl) phthalate</i>)		204-212-6	117-82-8	Toksike për riprodhimin te 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
154.	Eteri Bis(2-metoksietiliti) (<i>Bis(2-methoxyethyl) ether</i>)		203-924-4	111-96-6	Toksike për riprodhimin te njërëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
155.	Acidi arsemik (<i>Arsenic acid</i>)		231-901-9	7778-39-4	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



156.	Fibrat Refraktare Qeramike te Aluminosilikateve (<i>Aluminosilicate Refractory Ceramic Fibres</i>)	janë fibra të mbuluara nga numri i indeksit 650-017-00-8 në Shojcen VI, pjesa 3, tabela 3.1 e legjislacionit që rregullon klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, dhe plotësojnë tre kushtet e mëposhtme: a) Oksidet e aluminit dhe silicit janë përbërësit kryesorë të pranishëm (në fibra) brenda intervalit të përqendrimit të ndryshueshëm b) fibrat kanë një diametër mesatar gjeometrik të ponderuar të gjatësisë, më pak se dy gabime standarde gjeometrike prej 6 ose më pak mikrometra (µm) c) përmbajtja e oksidit alkaline dhe oksideve alkaline tokësore ($\text{Na}_2\text{O} + \text{K}_2\text{O} + \text{CaO} + \text{MgO} + \text{BaO}$) është më pak ose e barabartë me 18% të peshës	-	-	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
157.	4-(1,1,3,3-tetrametilbutil)fenoli (<i>4-(1,1,3,3-tetramethylbutyl)phenol</i>)		205-426-2	140-66-9	Substanca që mund të shkaktojë rregullime endokrine; (Neni 20, pika 4, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
158.	2-Metoksianiline, o-Anisidine (<i>2-Methoxyaniline, o-Anisidine</i>)		201-963-1	90-04-0	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



159.	2,2'-dikloro-4,4'-metilenedianiline (2,2'-dichloro-4,4'-methylenedianiline)		202-918-9	101-14-4	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
160.	1,2-dikloroetani (1,2-dichloroethane)		203-458-1	107-06-2	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
161.	Kromat Strontiumi (Strontium chromate)		232-142-6	7789-06-2	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
162.	Hidrazine (Hydrazine)		206-114-9	302-01-2, 7803-57-8	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
163.	Acetat i 2-etoksietilit (2-ethoxyethyl acetate)		203-839-2	111-15-9	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
164.	1-Metil-2-pirolidon (NMP) (1-Methyl-2-pyrrolidone (NMP))		212-828-1	872-50-4	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
165.	Acidi 1,2-Benzendikarboksilik, di-C7- 11-esteret alkilike te degezuara dhe linare (1,2-Benzenedicarboxylic acid, di-C7- 11-branched and linear alkyl esters)		271-084-6	68515-42-4	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
166.	Acidi 1,2-Benzendikarboksilik, di-C6- 8-esteret alkilike te degezuara, C7-te pasura (1,2-Benzenedicarboxylic acid, di-C6- 8-branched alkyl esters, C7-rich)		276-158-1	71888-89-6	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



167.	1,2,3-trikloropropani (1,2,3-trichloropropane)		202-486-1	96-18-4	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerezit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
168.	Sulfat Kobalti(II) (Cobalt(II) sulphate)		233-334-2	10124-43-3	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerezit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
169.	Dinitrat Kobalti(II) (Cobalt(II) dinitrate)		233-402-1	10141-05-6	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerezit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
170.	Diacetat Kobalti(II) (Cobalt(II) diacetate)		200-755-8	71-48-7	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerezit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



171.	Karbonat Kobaltit(II) (Cobalt(II) carbonate)		208-169-4	513-79-1	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve") #Toksike për riprodhimin te njerezit, kategorite 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
172.	Trioksid Kromi (Chromium trioxide)		215-607-8	1333-82-0	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve") #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
173.	Acide te gjeneruara nga trioksidi I kromit dhe oligomeret e tyre (Acids generated from chromium trioxide and their oligomers)		-	-	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
		Oligomeret e acidit kromik dhe acidit dikromik (Oligomers of chromic acid and dichromic acid)	-	-		
		Acidi kromik (Chromic acid)	231-801-5	7738-94-5		
		Acidi dikromik (Dichromic acid)	236-881-5	13530-68-2		
174.	2-metoksietanoli (2-methoxyethanol)		203-713-7	109-86-4	Toksike për riprodhimin te njerezit, kategorite 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa ©, e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



175.	2-etoksietanoli (2-ethoxyethanol)		203-804-1	110-80-5	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
176.	Trikloroetilene (Trichloroethylene)		201-167-4	79-01-6	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
177.	Heptaoksid natriumi tetraboron, hidrat (Tetraboron disodium heptaoxide, hydrate)		235-541-3	12267-73-1	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
178.	Kromat natriumi (Sodium chromate)		231-889-5	7775-11-3	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve") #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve") #Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve")	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
179.	Dikromat Kaliumi (Potassium dichromate)		231-906-6	7778-50-9	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve") #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 "Per menaxhimin e Kimikateve") #Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



						(c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
180.	Kromat Kaliumi (<i>Potassium chromate</i>)				232-140-5	7789-00-6	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)
181.	Tetraborat disodumi, anhidruar (<i>Disodium tetraborate, anhydrous</i>)				215-540-4	12179-04-3, 1303-96-4, 1330-43-4	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)
182.	Acid borik (<i>Boric acid</i>)	EC Nr. 233-139-2 dhe EC Nr. 234-343-4			-	-	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)
	Acid Borik, natyral i paepunuar (<i>Boric acid, crude natural</i>)			234-343-4		11113-50-1	
	Acid borik (<i>Boric acid</i>)			233-139-2		10043-35-3	
183.	Dikromat Amoni (<i>Ammonium dichromate</i>)				232-143-1	7789-09-5	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe



						1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
184.	Akriamide (<i>Acrylamide</i>)		201-173-7	79-06-1		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
185.	Fosfati i tris (2-kloroetil) (<i>Tris(2-chloroethyl) phosphate</i>)		204-118-5	115-96-8		Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
186.	Katran, qymyr katrani, temperaturë të lartë. (<i>Pitch, coal tar, high-temp.</i>)	-	266-028-2	65996-93-2		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #QBT (Neni 20, pika 3, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
187.	Sulfokromat plumbi i verdhe (C.I pigment i verdhe 34) (<i>Lead sulfochromate yellow (C.I. Pigment Yellow 34)</i>)	-	215-693-7	1344-37-2		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
188.	Sulfat molibdat kromat plumbi i kuq (C.I. Pigment i kuq 104)	-	235-759-9	12656-85-8		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a),	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



	<i>(Lead chromate molybdate sulphate red (C.I. Pigment Red 104))</i>					e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
189.	Kromat plumbi <i>(Lead chromate)</i>	231-846-0	7758-97-6			Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
190.	Fialat diisobutili <i>(Diisobutyl phthalate)</i>	201-553-2	84-69-5			Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Substanca që mund të shkaktojë çrregullime endokrine; (Neni 20, pika 4, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
191.	Vaj antraceni, antracene i ulet <i>(Anthracene oil, anthracene-low)</i>	292-604-8	90640-82-7	-		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #QBT (Neni 20, pika 3, germa (a), e Ligjit 27/2016	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



							“Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
192.	Vaj antraceni, past antraceni (distn.Drite) (<i>Anthracene oil, anthracene paste, distn. Lights</i>)	-	295-278-5	91995-17-4			Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #QBT (Neni 20, pika 3, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
193.	Vaj antraceni, paste antraceni, fraksione antraceni (<i>Anthracene oil, anthracene paste, anthracene fraction</i>)	-	295-275-9	91995-15-2			Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #QBT (Neni 20, pika 3, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
194.	Vaj antraceni, paste antraceni (<i>Anthracene oil, anthracene paste</i>)	-	292-603-2	90640-81-6			Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



						#QBT (Neni 20, pika 3, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
195.	Vaj antraceni (<i>Anthracene oil</i>)	-	292-602-7	90640-80-5		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #QBT (Neni 20, pika 3, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
196.	2,4-dinitrotolueni (<i>2,4-dinitrotoluene</i>)		204-450-0	121-14-2		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
197.	Arsenate trietili (<i>Triethyl arsenate</i>)	-	427-700-2	15606-95-8		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
198.	Dikromat natriumi (<i>Sodium dichromate</i>)		234-190-3	10588-01-9, 7789-12-0		Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Mutagjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (b), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerezit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



199.	Arsenat hidrogjen plumbi (<i>Lead hydrogen arsenate</i>)		232-064-2	7784-40-9	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerezit, kategorite 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
	Hekzabromociklododekane (HBCDD) (<i>Hexabromocyclododecane (HBCDD)</i>)	dhe të gjithë diastereoizomerët kryesorë të identifikuar	-	-	QBT (Neni 20, pika 3, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
200.	Hekzabromociklododekani (<i>Hexabromocyclododecane</i>)		247-148-4	25637-99-4		
	gamma-hekzabromociklododekani (<i>gamma-hexabromocyclododecane</i>)		-	134237-52-8		
	1,2,5,6,9,10-hekzabromociklododekani (<i>1,2,5,6,9,10-hexabromocyclododecane</i>)		221-695-9	3194-55-6		
	alfa-hekzabromociklododekani (<i>alpha-hexabromocyclododecane</i>)		-	134237-50-6		
	beta-hekzabromociklododekani (<i>beta-hexabromocyclododecane</i>)		-	134237-51-7		
201.	Ftalate te Dibutilit (DBP) (<i>Dibutyl phthalate (DBP)</i>)		201-557-4	84-74-2	Toksike për riprodhimin te njerezit, kategorite 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Substanca që mund të shkaktojne çrregullime endokrine; (Neni 20, pika 4, germa (a), e Ligjit 27/2016	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



						“Per menaxhimin e Kimikateve”	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
202.	Trioksid Diarseniku (<i>Diarsenic trioxide</i>)		215-481-4		1327-53-3	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
203.	Pentaoksid Diarseniku (<i>Diarsenic pentaoxide</i>)		215-116-9		1303-28-2	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
204.	Diklorid Kobalti (<i>Cobalt dichloride</i>)		231-589-4		7646-79-9	Kancerogjene 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
205.	Oksid Bis(tributilkallaj) (TBTO) (<i>Bis(tributyltin) oxide (TBTO)</i>)		200-268-0		56-35-9	QBT (Neni 20, pika 3, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
206.	Ftalati i Bis (2-etilhekzili) (DEHP) (<i>Bis (2-ethylhexyl)phthalate (DEHP)</i>)		204-211-0		117-81-7	Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Substanca që mund të shkaktojë çrregullime endokrine; (Neni 20, pika 4, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Substanca që mund të shkaktojë çrregullime	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi



						endokrine; (Neni 20, pika 4, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	Data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi
207.						Toksike për riprodhimin te njerëzit, kategoritë 1A dhe 1B (Neni 20, pika 2, germa (c), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”) #Substanca që mund të shkaktojnë erregullime endokrine; (Neni 20, pika 4, germa (a), e Ligjit 27/2016 “Per menaxhimin e Kimikateve”)	85-68-7
208.						Ftalati i Benzil butilut (BBP) (Benzyl butyl phthalate (BBP))	201-622-7
						Antraceni (Anthracene)	204-371-1
209.						Alkanet, C10-13, kloro (Parafinat e klorinuara me zinxhir te shkurter) (Alkanes, C10-13, chloro (Short Chain Chlorinated Paraffins))	287-476-5
210.						5-tert-butil-2,4,6-trinitro-m-ksilene (Musk ksilene) (5-tert-butyl-2,4,6-trinitro-m-xylene (Musk xylene))	85535-84-8
211.						4,4'- Diaminodifenilmetani (MDA) (4,4'- Diaminodiphenylmethane (MDA))	202-974-4

Shenim: Kjo tabelë mbyllet me nr rendor 211.

**UDHËZIM****Nr. 8, datë 8.4.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
DHE TË PROCEDURAVE PËR
DHËNIEN E MEDALJES SË ARTË
NXËNËSVE TË SHKËLQYER NË VITE,
PAS PËRFUNDIMIT TË ARSIMIT TË
MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

**KREU 1
KRITERET PËR PËRFTITIMIN E
MEDALJES SË ARTË**

1. Nxënësit të shkëlqyer ndër vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, i jepet “Medalje e artë”, nëse plotëson njëherësh kriteret e mëposhtme:

a) Ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00.

b) Në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të Maturës Shtetërore (MSH) është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.50.

c) Në provimin kombëtar me zgjedhje të MSH-së është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 10.00.

d) Ka vlerësimin në sjellje “Shumë mirë”, në gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë.

2. Nderohet me “Medalje e artë” nxënësi që është fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, sipas rregullores “Për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrja e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare”.

**KREU 2
PROCEDURA PËR DHËNIEN E
“MEDALJES SË ARTË”**

1. Në javën e parë të vitit shkollor institucionet arsimore parauniversitare përgatitin dhe dërgojnë

në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), listat dhe dosjet e nxënësve që plotësojnë kriteret për “Medalje e artë”, sipas kreut 1 të këtij udhëzimi.

2. Dosja e nxënësit përmban dokumentet e mëposhtme:

a) fotokopjen e kartës së identitetit;

b) fotokopjen e diplomës dhe certifikatës së MSH-së;

c) vlerësimin për sjelljen, për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë, lëshuar nga drejtorja e institucionit arsimor parauniversitar;

d) fotokopjen të certifikatës që nxënësi ka fituar, sipas pikës 2, të kreut 1 të këtij udhëzimi nëse ai e disponon.

3. ZVAP-të nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP), përcjellin brenda një jave listat dhe dosjet e nxënësve në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP).

4. DPAP-ja dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), listën e nxënësve të propozuar për “Medalje e artë”, e cila pasi kryen verifikimet për secilin nxënë lidhur me notën mesatare të shkollës së mesme, notën e shkallëzuar të provimeve të detyruara dhe të provimit me zgjedhje, si dhe certifikatën që nxënësi ka fituar në olimpiadën ndërkombëtare, e përcjell atë brenda një jave në DPAP.

5. DPAP-ja përcjell në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), dosjet e nxënësve së bashku me listën e verifikuar nga QSHA.

6. MASR-ja, pasi bën verifikimin përfundimtar të dosjes për secilin nxënë, sipas kriterëve dhe procedurave të këtij udhëzimi, përcjell në Kryeministri listën e nxënësve që u jepet “Medalje e artë”, të shoqëruar me projekturdrin dhe relacionin shoqërues.

**KREU 3
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË
FUNDIT**

1. MASR-ja ka detyrimin të prodhojë “Medalje e artë” për të gjithë nxënësit që i përfitojnë ato.

2. Nxënësi, i cili pajiset me “Medalje e artë”, nuk ka përfitime të tjera financiare.

3. MASR-ja mban në një regjistër të veçantë të dhënat e nxënësve, të cilët janë pajisur me medaljen e artë.

4. Udhëzimi nr. 21, datë 2.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për



dhënien e ‘Medaljes së artë’”, i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

UDHËZIM
Nr. 9, datë 9.4.2021

**PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE
KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË,
VITI SHKOLLOR 2020–2021
(SESIONI I PARË)**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 e 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë për vitin shkollor 2020–2021 (sesioni i parë) do të zhvillohen si më poshtë:

- lënda “Gjuhë shqipe”, më 16 qershor 2021;
- lënda “Matematikë”, më 21 qershor 2021;
- lënda “Gjuhë e huaj” e parë, më 25 qershor 2021.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare”. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën “Gjuhë amtare” do të zhvillohet më 11 qershor 2021.

3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren për zhvillimin e

provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë.

4. Gjuhët e huaja të para, që do të jepen si provim i detyruar, janë: Anglisht, Frëngjisht, Italisht dhe Gjermanisht. Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

6. Çdo provim kombëtar i arsimit bazë fillon në orën 10:00 dhe zgjat 2 orë e 30 minuta.

7. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare greke, ndiqet procedura si vijon:

a) testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier;

b) mësuesit dhe pedagogu që hartojnë testin propozohen nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Gjirokastrë–Libohovë, ZVAP Finiq–Dropull dhe ZVAP Sarandë–Konispol–Delvinë;

c) grupi i punës që përgatit testin mbledhet në ZVAP Gjirokastrë–Libohovë;

ç) testi tërhiqet në ZVAP Gjirokastrë–Libohovë;

d) përfaqësuesit e ZVAP Finiq–Dropull dhe ZVAP Sarandë–Konispol–Delvinë e tërheqin testin në ZVAP Gjirokastrë–Libohovë, një ditë para provimit, ndërsa ata të ZVAP Gjirokastrë–Libohovë e tërheqin testin në ditën e provimit.

8. Për hartimin e testit në lëndën “Gjuhë amtare” të pakicës kombëtare maqedonase, ndiqet procedura si vijon:

a) testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Korçë;

b) grupi i punës që përgatit testin mbledhet në DRAP Korçë;

c) testi tërhiqet në DRAP Korçë;

ç) përfaqësuesit e ZVAP Korçë–Pustec e tërheqin testin në ditën e provimit.

9. Nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare, bazuar në planin edukativ individual me të cilin punojnë në përshtatje me veçoritë e tyre.



10. Drejtoria e institutit të nxënësve që nuk shikojnë “Ramazan Kabashi”, e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.

11. Nxënësit mbetës në provimet kombëtare të arsimit bazë kanë të drejtë t'i japin ato në sesionin e dytë sipas procedurave të parashikuara në rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë.

12. Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVAP, merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet DRAP-së në QSHA dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtarë vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

VENDIM

Nr. 14, datë 11.3.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska,	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “
Altin Binaj	anëtar i “ “
Përparim Kalo	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.3.2021,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë

dokumentesh çështjen nr. 1 (F) 2019 i Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Frida Molla

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.; Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 387/1, datë 28.2.2019, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 31, pika 1, e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi pretendimet me shkrim të kërkuases Frida Molla, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, shoqërisë OSHEE sh.a. dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuessa Frida Molla është pronare e një truall prej 118 m², i ndodhur në qytetin e Korçës, në të cilin shoqëria CEZ Shpërndarje (sot OSHEE sh.a.), në vitin 2005 ka kryer disa punime për kalimin e dy linjave të kabllove elektrike të tensionit të lartë. Me konstatimin e kryerjes së punimeve, kërkuessa i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesëpadi me objekt ndalimin e punimeve dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme.

2. Me vendimin nr. 717, datë 7.4.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ndalimin e punimeve dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 173, datë 27.6.2006.



3. CEZ Shpërndarje ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë dhe ka kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë deri në përfundimin e shqyrtimit të rekursit. Me vendimin nr. 144 regj., datë 8.9.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

4. Vendimi i pezullimit është kundërshtuar nga kërkesja në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 59, datë 16.5.2007, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se ai nuk është përfundimtar, në kuptim të nenit 131, shkronja “P”, të Kushtetutës.

5. Kërkesja, me pretendimin se vendimet gjyqësore që urdhëronin ndërprerjen e menjëhershme të punimeve nuk janë zbatuar asnjëherë, duke cenuar të drejtën e saj për të gëzuar qetësisht pronën, ka paraqitur në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) kërkesën nr. 29680/07 për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 33, datë 11.1.2008, ka vendosur mospranimin e rekursit të CEZ Shpërndarje kundër vendimit nr. 173, datë 27.6.2006, të Gjykatës së Apelit Korçë. Për rrjedhojë, ka rënë edhe masa e pezullimit e vendosur me vendimin nr. 144 regj., datë 8.9.2006.

7. Në vitin 2011, në kushtet kur vendimi për ndalimin e punimeve dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme nuk po ekzekutohej, kërkesja ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë me objekt detyrimin e CEZ Shpërndarje dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për ta shpërblyer për përdorimin e sendit, fitimin e munguar dhe dëmin e shkaktuar, si dhe për fitimin e realizuar nga përdorimi i sendit.

8. Me vendimin nr. 41-2014-202 (101), datë 21.1.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, duke detyruar CEZ Shpërndarje të shpërblejë kërkesuesen Frida Molla për përdorimin e truallit të saj në shumën 24.600 lekë në muaj ose 295.000 lekë në vit, duke filluar prej datës 27.6.2006, deri në momentin e lirimit dhe të dorëzimit të truallit, si dhe të paguajë fitimin e munguar në shumën 295.000 lekë në vit dhe interesat bankare.

9. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi me vendimin nr. 259, datë 22.7.2014, të Gjykatës së Apelit Korçë me saktësimin: “... *detyrimin e palës së paditur CEZ Shpërndarje sh.a. lidhur me vlerën e përdorimit të sendit në shumën 2.231.712 lekë dhe vlerën e fitimit të munguar në shumën 840.946,51 lekë, detyrim i cili fillon nga data 27.6.2006 deri më datë 22.1.2014.*”.

10. CEZ Shpërndarje ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, si dhe kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të sipërcituara.

11. Me vendimin nr. 387, datë 21.10.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “*Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 101, datë 21.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi me vendimin nr. 259, datë 22.7.2014, të Gjykatës së Apelit Korçë.*”.

12. Ndërkohë, GJEDNJ-ja, në lidhje me kërkesën nr. 29680/07 (*Molla kundër Shqipërisë*), me vendimin e datës 8.12.2016, ka konstatuar shkeljen e nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të saj në lidhje me moszbatimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Lartë të datës 11 janar 2008, duke vlerësuar, se: “... *çdo mosveprim ose gabim në lidhje me urdhrin e gjykatës për ekzekutim vendimi duhet të merret përsipër nga shteti dhe të mos kompensohet nga individit në fjalë. Për pasojë, Gjykata nuk mund të pranojë argumentin se ankuesja duhet të kishte gjetur mënyra alternative për të ekzekutuar vendimin e formës së prerë; në të vërtetë një person, i cili ka fituar një vendim kundër shtetit mund të mos pritët të paraqesë procedura të veçanta për zbatimin e vendimit. Në çështjen konkrete, autoritetet shtetërore në fjalë nuk zbatuan vendimin, pavarësisht kërkesave të përsëritura të përmbareshit, për ta bërë një gjë të tillë në një bark kohor prej tetë vitesh.*” (*shih paragrafin 42 të vendimit*). Në lidhje me pretendimin për zbatimin e nenit 41 të Konventës, GJEDNJ-ja është shprehur: “...*Gjykata vëren se ankuesja ka pretenduar për dëme monetare dhe jomonetare me qëllimin për një zgjidhje miqësore të çështjes, por nuk ka bërë ndonjë kërkesë specifike në procedurën kundërshtuese. Gjithashtu, Gjykata vëren faktin se procedurat për kompensim dhe humbje të përfitimit janë ende pezull përpara gjykatave vendase.*” (*paragrafët 45 dhe 46 të vendimit*).

13. Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 415, datë 4.7.2018, me këtë përmbajtje: “1. *Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të*



Drejtat e Njeriut, datë 8.12.2016, për çështjen “Molla kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 29680/07). 2. Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së, të bëhet ekzekutimi me mjete të përshtatshme i vendimit nr. 00-2008-33, datë 11.1.2008, të Gjykatës së Lartë, të dhënë në favor të ankueses, znj. Frida Molla, për lënien në fuqi të vendimit nr. 173, datë 27.6.2006, të Gjykatës së Apelit Korçë, e cila ka vendosur detyrimin e Ndërmarrjes Zonale të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Korçë për të ndaluar punimet në pronën e paditëses Frida Molla, si dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme. 3. Ekzekutimi i vendimit të GJEDNJ-së, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të bëhet nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Korçë. 4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria Rajonale e OSHEE sh.a., Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.”.

14. Në rrethanat e mësipërme, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për revokimin e vendimit të pezullimit nr. 387, datë 21.10.2014, të asaj gjykate, në mbështetje të nenit 479, pika 6, të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 387/1, datë 29.2.2019, ka vendosur mospranimin e kërkesës, me arsyetimin se ajo nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 479, pika 6, i KPC-së.

15. Në datën 3.6.2019, kërkesja i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 387/1, datë 29.2.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën.

16. Gjykata vë në dukje se prej datës 16 korrik të vitit 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për formimin dhe funksionimin e kolegjit për shqyrtimin paraprak të kërkesave. Pas plotësimit të këtij kuorumi, me vendimin e datës 5.2.2020, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, pas plotësimit të kuoromit ligjor të saj, me vendimin e datës 2.2.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

17. Kërkesja Frida Molla ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimi i kundërshtuar cenon:

17.1 Të drejtat kushtetuese dhe konventore, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka përsëritur shkeljet e bëra më parë me vendimin nr. 387, datë

21.10.2014, që pezulloi ekzekutimin e titullit ekzekutiv “vendimi i formës së prerë nr. 101, datë 21.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi me vendimin nr. 259, datë 22.7.2014, të Gjykatës së Apelit Korçë”.

17.2 Të drejtën për të marrë pjesë dhe për t’u dëgjuar në gjykim, pasi seanca gjyqësore është zhvilluar pa praninë e kërkujeses, duke mos u njoftuar për ditën dhe orën e gjykimit. Edhe pas ndryshimeve në KPC njoftimi i palëve për ditën dhe orën e gjykimit kryhet me shpalljen e lajmërimeve në mjediset e Gjykatës së Lartë. Për sa kohë që ligji lejon gjykimin në mungesë të palëve të interesuara, fjalia e fundit e pikës 6 të nenit 479 të KPC-së duhet të shfuqizohet si e papajtueshme me Kushtetutën.

17.3 Standardin e arsytimit të vendimit, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit dhe ai për mospranimin e kërkesës për revokimin e tij nuk janë arsyetuar, por përmendin vetëm kërkimet e palëve.

18. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkujeses, sa vijon:

18.1 Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për çështjen konkrete, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë nuk është përfundimtar në kuptim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000.

18.2 Pretendimi për mungesën e arsytimit të vendimit është i pabazuar, pasi vendimi i kundërshtuar, edhe pse është i një natyre tjetër, është i arsyetuar në përputhje me nenin 479, pika 7, të KPC-së dhe përmbush të gjitha standardet e një procesi të rregullt ligjor.

18.3 Gjykata e Lartë ka zhvilluar proces të drejtë në drejtim të kontradiktoritetit në gjykim, pasi kërkesja i ka parashtruar në kërkesë të gjitha pretendimet për revokimin e masës së pezullimit dhe ato janë marrë efektivisht në shqyrtim nga ajo gjykatë.

18.4 Pretendimi se shkelja e të drejtave procedurale të kërkujeses është edhe pasojë e ligjit është i pabazuar, pasi nuk është ngritur në nivel kushtetues. Përkundrazi, pika 6 e nenit 479 të KPC-së synon respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe dhënien e një drejtësie efektive.

18.5 Vendimi i GJEDNJ-së në çështjen *Molla kundër Shqipërisë* është ekzekutuar tërësisht, pasi linja elektrike është hequr nga prona e kërkujeses, duke e kthyer atë në gjendjen e mëparshme.



19. Subjekti i interesuar, OSHEE sh.a., ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkuases, sa vijon:

19.1 Gjykata e Lartë ka zbatuar pikën 6 të nenit 479 të KPC-së, për rrjedhojë pretendimi për zhvillimin e procesit gjyqësor pa praninë e palëve nuk qëndron.

19.2 Vendimi i kundërshtuar përmban të gjitha elementet e përcaktuara nga ligji procedural, duke përmbushur standardin kushtetues të arsyetimit.

19.3 Vendimi i kundërshtuar është i drejtë, pasi në kërkesën për revokim kërkuessa qëllimisht ka përfshirë dy procese gjyqësore me objekte të ndryshme, çka e ka pasqyruar edhe në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Masa e pezullimit i përket çështjes me objekt shpërblimin e vlerës së përdorimit të sendit, kurse pretendimet e saj për revokimin e vendimit të pezullimit lidhen me procesin gjyqësor të ndalimit të punimeve dhe kthimit në gjendjen e mëparshme, me të cilin lidhet edhe vendimi i GJEDNJ-së. Vendimi i kundërshtuar nuk ka asnjë rrethanë të ndryshme lidhur me procesin për të cilin është vendosur masa e pezullimit.

19.4 Vendimi i GJEDNJ-së është ekzekutuar plotësisht, pasi kabllot e dy linjave të tensionit të lartë janë hequr dhe me vendimin nr. 236, datë 12.2.2020, Zyra e Përmbartimit Korçë ka vendosur pushimin e urdhrit të ekzekutimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuases

20. Çështja e legjitimitimit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, llojin e pasojave negative të pësura dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

21. Gjykata vëren se kërkuessa legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin ka ngritur pretendime në Gjykatën Kushtetuese, për rrjedhojë provon interesin e drejtpërdrejtë në këtë çështje.

22. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve ligjore*, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individ duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuessi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shtih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata vëren se në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohej vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliave dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shtih vendimet nr. 29, datë 30.3.2017; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sipas kërkuases, duke shfrytëzuar mundësinë që krijuan ndryshimet e KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ajo ka paraqitur kërkesë për revokimin e vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 387, datë 21.10.2014, i cili, në mënyrë të kundërligjshme, ka vendosur pezullimin e vendimit civil të formës



së prerë, kërkesë që nuk iu pranua. Sipas saj, Gjykata e Lartë me vendimin e kundërshtuar ka zgjidhur përfundimisht çështjen e vlerës së dëmit të shkaktuar, vlerës së përdorimit të sendit etj., dhe nga mënyra se si është marrë ky vendim, pa njoftuar palët dhe pa arsyetuar shkaqet e kësaj vendimmarrjeje, kërkuesses i është mohuar e drejta për një proces të rregullt.

25. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka kundërshtuar marrjen në shqyrtim të kësaj çështjeje nga Gjykata Kushtetuese, duke argumentuar se kërkuessa nuk ka shteruar mjetet juridike, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë nuk është përfundimtar në kuptim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000.

26. Gjykata vëren se objekt i këtij gjykimi kushtetues është vendimi nr. 387/1, datë 28.2.2019, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka shqyrtuar kërkesën për revokimin e vendimit nr. 387, datë 21.10.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, që ka njohur të drejtën e kërkuesses për t'u shpërblyer për përdorimin e truallit dhe fitimin e munguar.

27. Gjykata nuk vë në dyshim karakterin e ndërmjetëm si të vendimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, ashtu edhe të vendimit për mospranimin e kërkesës për revokimin e vendimit të pezullimit, i cili, sipas pikës 6 të nenit 479 të KPC-së, parashikohet si një mjet i ri ankimi që u jep mundësi palëve ndërgjyqëse të kërkojnë rivendosjen e së drejtës së shkelur. Ajo, gjithashtu, rritet qëndrimin e mbajtur prej saj se, në parim, vendime të kësaj natyre, për marrjen e masës provizore të pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, nuk mund të konsiderohen si përfundimtare për efekt të gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Në të tilla raste kërkuessit i kanë të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tyre gjatë shqyrtimit të çështjes në themel, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese pranë kësaj Gjykate.

28. Megjithatë, në raste përjashtimore, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin e saj edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, siç janë ato të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë, me arsyetimin se çështjet që zgjidhen në këtë fazë nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi gjyqësor në fazën e dytë, e cila fillon kur vendimi i fazës së parë ka marrë

formë të prerë. Sipas Gjykatës, vendimi i fazës së parë të pjesëtimit është një vendim përfundimtar për problemet që ngrihen në Gjykatën Kushtetuese dhe, si rrjedhojë, nuk mund të vlerësohet se kërkuessi nuk i ka shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P” të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjithashtu, Gjykata ka marrë në shqyrtim edhe kërkesat për shfuqizimin e vendimeve të caktimit të masave të sigurimit personal në procedimet penale, të cilat, gjithashtu, janë vendime që jepen në procedura të veçanta në funksion të procedimit penal të themelit. Në rastin e pretendimeve ndaj vendimeve gjyqësore për masat e sigurimit (caktimin ose zëvendësimin e tyre), Gjykata ka vlerësuar se ato bëjnë pjesë *ratione materiae* në juridiksionin e Gjykatës. Në rastet kur kërkuessi i ka shteruar mjetet e ankimit për masën e sigurimit penal “arrest në burg” dhe ankohet ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë për këtë masë, është vlerësuar se ky lloj vendimi gjyqësor konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së është pranuar përjashtimi nga rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit në rastet që lidhen me procedurat e ndërmjetme që përcaktojnë të drejta civile për ankuesin. Neni 6, pika 1, i KEDNJ-së vihet në zbatim kur ekziston një mosmarrëveshje për një “të drejtë civile”, e cila njihet nga ligji i brendshëm, pavarësisht nëse mbrohet edhe nga Konventa. Procedurat paraprake, siç janë ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme, ku përfshihet edhe masa e sigurimit të padisë, si rregull nuk përcaktojnë të drejta dhe detyrime civile, prandaj ato nuk përfshihen në mbrojtjen e nenit 6. Por shpesh, procedimet paraprake dhe ato të themelit vendosin të njëjtat “të drejta ose detyrime civile” dhe kanë të njëjtat efekte që zgjasin në kohë ose janë të përhershme. Prandaj, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se procedurat e masave të sigurimit të padisë nuk karakterizohen automatikisht si jopërcaktuese të të drejtave ose detyrimeve civile. Po ashtu, ajo është shprehur se nuk krijohet bindja se një defekt në një procedurë të tillë do të riparohej domosdoshmërisht në një fazë të mëvonshme, pra në procedurat e themelit, për të cilat zbatohet neni



6, pasi çdo dëm i pësuar mund të jetë bërë ndërkohë i pakthyesëm dhe me pak mundësi reale për ta riparuar atë, përveçse, ndoshta, mundësisë së kompensimit në para (*shih vendimin në çështjen Micallef kundër Maltës, datë 15 tetor 2009, paragrafët 78–80*).

31. Gjykata thekson se në çështjen konkrete nuk synon të largohet nga jurisprudenca e saj e deritanishme në lidhje me vendimet që vendosin masa të ndërmjetme për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Gjykata ripohon qëndrimin se këto lloj vendimesh nuk janë përfundimtare në lidhje me të drejtat themelore, në rastin konkret e drejta e pronës private, për pasojë nuk vendosin automatikisht në lidhje me të drejta ose detyrime civile. Ato janë masa të përkohshme të marra gjatë procedurës së themelit të çështjes dhe nuk konsiderohen si një procedurë e veçantë, e ndarë nga ajo kryesore.

32. Gjykata duke pasur parasysh natyrën e veçantë të çështjes konkrete, që lidhet me detyrimet për zbatimin e vendimit të GJEDNJ-së dhënë në favor të kërkuësës, si dhe në këndvështrim të kohëzgjatjes tërësore të procesit, vlerëson se duhet të ndalet në analizën e kritereve që bëjnë të zbatueshëm përjashtimin nga rregulli i mësipërm.

33. Në këtë pikëpamje, duke iu referuar përmbajtjes së nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, i cili përcakton natyrën “përfundimtare” të gjykimit kushtetues, Gjykata rithekson se, si rregull, individi mund t’i drejtohet asaj për kontrollin e kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur në mënyrë përfundimtare mbi të drejtën kushtetuese që pretendohet të jetë cenuar. Duke pasur parasysh edhe natyrën e kontrollit kushtetues individual, si dhe në varësi të rrethanave konkrete të çështjes rast pas rasti, Gjykata, përjashtimisht nga ky rregull, vlerëson se kontrollit kushtetues mund t’i nënshtrohen edhe vendimet e ndërmjetme që jepen gjatë një procesi gjyqësor. Megjithatë, ky përjashtim zbatohet vetëm kur plotësohen disa kritere që lidhen me pasojat e drejtpërdrejta ndaj së drejtës së individit. Në këtë kuptim, vendimi i ndërmjetëm duhet që të ketë vendosur mbi të drejtën e individit të pretenduar të cenuar, të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar. Po ashtu, ky lloj vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i

themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë. Po aq rëndësi ka edhe fakti që shkëlja e pretenduar të jetë pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm të kundërshtuar, pra kërkuësja duhet të provojë se është viktimë e shkeljes të së drejtës kushtetuese.

34. Duke i zbatuar kriteret e mësipërme në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkesa për revokimin e masës së pezullimit është bazuar në vendimin e GJEDNJ-së të datës 8 dhjetor 2016, i cili ka konstatuar se është shkelur neni 6, pika 1, i KEDNJ-së dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj dhe është shprehur se shteti shqiptar duhet të sigurojë, me mjete të përshtatshme, ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të datës 11.1.2008, të Gjykatës së Lartë për pushimin e cenimit të pronës së kërkuësës. Ndërsa kërkesa për shpërblimin e dëmit financiar dhe jofinanciar nuk u pranua nga GJEDNJ-ja, për sa kohë që procedurat për kompensim dhe fitim të munguar ishin ende në shqyrtim në gjykatat shqiptare. Pas dhënies së këtij vendimi, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 415, datë 4.7.2018, me të cilin ka vendosur ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së për çështjen *Molla kundër Shqipërisë*, dhe që në zbatim të tij të bëhet ekzekutimi me mjete të përshtatshme nga ana e Drejtorisë Rajonale të OSHEE Korçë i vendimit nr. 33, datë 11.1.2008, të Gjykatës së Lartë.

35. Sipas subjekteve të interesuara, shoqërisë OSHEE sh.a. dhe Avokaturës së Shtetit, vendimi i GJEDNJ-së është ekzekutuar plotësisht, duke u hequr kabllot e dy linjave të tensionit të lartë dhe me vendimin nr. 236, datë 12.2.2020, Zyra e Përmbarrimit Korçë ka vendosur pushimin e urdhrit të ekzekutimit. Për rrjedhojë, me shkresën nr. 840/4 prot., datë 15.2.2021, Avokatura e Shtetit i ka dërguar informacion Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së se vendimi është ekzekutuar tërësisht dhe se nuk ka më nevojë të merren masa të tjera për këtë çështje. Lidhur me këtë informacion, Gjykata, para vlerësimit të çështjes konkrete, çmon të theksojë se, në përputhje me nenin 14, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilit gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja, si dhe me nenin 22 të ligjit



nr. 8577/2000, i cili përcakton një nga parimet e gjykimit kushtetues, subjektet pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues duhet të marrin masat që aktet që paraqesin në këtë Gjykatë të jenë të hartuara ose të përkthyer në gjuhën shqipe.

36. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim nuk ka vend për përjashtim nga zbatimi i kritereve të sipërcituara që lidhen me natyrën përfundimtare të vendimit objekt i ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë nuk përcakton të drejta ose detyrime civile për kërkuesen dhe as masën e dëmshpërblimit në lidhje me cenimin e së drejtës së pronës, proces që është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, e cila do të vendosë përfundimisht në lidhje me këtë çështje. Thënë ndryshe, me anë të këtij vendimi kërkueses i shkaktohen vonesa në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë që është shprehur në lidhje me masën e dëmshpërblimit që rrjedh nga cenimi i së drejtës së pronës private. Megjithatë, kërkuesja ka mjete të tjera ligjore që i ofrohen nga legjislacioni në fuqi, nëpërmjet të cilave individëve u garantohet mbrojtja efektive për pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si dhe për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë kuptim, KPC-ja përcakton se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), mjetet e mbrojtjes (kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave (neni 399/4), shpërblimi i drejtë (neni 399/3), gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7) etj.

37. Për sa më sipër, vendimi i kundërshtuar nr. 387/1, datë 28.2.2019, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, prandaj kërkuesja nuk legjitimohet për paraqitjen e këtij ankimi kushtetues individual.

38. Megjithatë, Gjykata, duke pasur parasysh statusin e veçantë që ka KEDNJ-ja në rendin e brendshëm ligjor, ka njohur kompetencën ekskluzive të GJEDNJ-së në sistemin tonë juridik dhe efektin e drejtpërdrejtë të vendimeve të saj në interpretimin e standardeve kushtetuese të të drejtave të njeriut, veçanërisht atyre që i referohen së drejtës për proces të rregullt ligjor, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Vendimet e GJEDNJ-

së kanë vlerën e tyre në dy aspekte: i pari lidhet me natyrën detyruese, që rrjedh nga nenet 1 dhe 46 të Konventës, dhe i dyti me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. GJEDNJ-ja ka sqaruar parimet që rregullojnë zbatimin e vendimeve të saj, duke i vënë theksin zbatimit efektiv të këtyre vendimeve. Sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë, për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose Protokollet e saj, ka detyrimin të veprojë në përputhje me vendimin e asaj gjykate. Me fjalë të tjera, një dështim tërësor ose i pjesshëm i ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së lind përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit. Shteti në fjalë ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga gjykata dhe të rregullojë pasojat e shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja (*shih vendimin nr. 45, datë 1.11.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Detyrimet e marra përsipër nga shteti shqiptar në kuadrin e KEDNJ-së janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh vendin e Gjykatës së Lartë në piramidën gjyqësore, por pa vënë në diskutim kompetencat e këtij organi gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjeve, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhet të shfaqë një kujdes të shtuar në përsheptimin e procedurave, veçanërisht në rastet kur GJEDNJ-ja ka konstatuar cenim të të drejtave të kërkuesve dhe ka rekomanduar marrjen e masave nga shteti shqiptar për rivendosjen e tyre.

40. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesja Frida Molla duhet të rrëzohet, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e



Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.3.2021.

Shpallur më 9.4.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Përparim Kalo, Altin Binaj, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 73, datë 12.3.2021

**MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES
MBI PROCEDURAT PËR DHËNIEN E
SË DREJTËS SË PËRJASHTIMIT, PËR
INFRASTRUKTURËN E RE TË GAZIT
NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 38, 43, pika 1 dhe të nenit 78, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/4 prot., datë 9.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi miratimin e “Rregullores mbi procedurat për dhënie e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 148, datë 10.9.2020, Bordi i ERE-s ka vendosur: “Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores mbi procedurat për dhënie e së drejtës së përjashtimit, për infrastrukturën e re të gazit natyror”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, u bënë publikimet në faqen e *web*-it të ERE-s, njoftimi në median e shkruar me shkresën e ERE nr. 62/29 prot., datë 18.9.2020, si dhe njoftimi për botimin në Fletoren Zyrtare, botuar në nr. 171, datë 25.9.2020.

- Për të marrë opinionet e palëve të interesuara, referuar vendimit të Bordit nr. 148, datë 10.9.2020, ERE, me anë të shkresës nr. 1105 prot., datë 18.9.2020, iu drejtua: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, “Albpetrol” sh.a., “Phoenix Petroleum” sh.a., “Albgaz” sh.a., “CGC” sh.p.k., “Balkgaz” sh.p.k., “TAP AG Albania” sh.p.k., “GSA” sh.p.k. dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, me qëllim që palët e interesuara të shprehnin, brenda 30 ditëve, opinionet dhe komentet e tyre.

- Në përfundim të afatit, me qëllim dhënien apo marrjen e mendimeve ose propozimeve në lidhje me “Rregulloren mbi procedurat për dhënie e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror”, rezultoi se me shkresën nr. 6683/1 prot., datë 16.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1105/2 prot., datë 9.12.2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përmes shkresës nr. 175 prot., datë 1.10.2020, protokolluar në ERE me nr. 1105/1 prot., datë 1.10.2020, “Albgaz” sh.a., shprehen parimisht dakord për fillimin e kësaj procedure.

- Nuk rezultoi të ketë asnjë koment, vërejtje apo sugjerim nga palët e tjera të interesit në lidhje me përmbajtjen e “Rregullores mbi procedurat për dhënie e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror”, për të cilin Bordi i ERE-s ka filluar procedurën.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores mbi procedurat për dhënie e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
ERE-s NR. 73, DATË 12.3.2021

RREGULLORE
MBI PROCEDURAT PËR DHËNIEN E SË
DREJTËS SË PËRJASHTIMIT, PËR
INFRASTRUKTURËN E RE TË GAZIT
NATYROR

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i “Rregullore mbi procedurat për dhënie e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror”, (më poshtë – “Rregullorja”) është të përcaktojë rregullat për një procedurë përjashtimi transparente, jodiskriminuese dhe të arsyetuar në përputhje me rregullat e paketës së tretë të energjisë, që përfshin rolin e Entit Rregullator të Energjisë (këtu dhe më poshtë “ERE”).

2. Objekti i kësaj rregulloreje është të sigurojë nxitjen e investimeve në infrastrukturën kryesore të re, ndërkohë që siguron funksionimin si duhet të tregut të gazit natyror.

Neni 2

Fusha e veprimt

1. Kjo rregullore aplikohet për përjashtimin e infrastrukturës kryesore të re, më poshtë: interkonjektorët midis Shqipërisë dhe palëve të tjera të Komunitetit të Energjisë, Gazit Natyror të Lëngshëm dhe hapësirat e depozitimit të përshkruara në nenin 3 më poshtë.

2. Rregullorja përcakton kërkesat e procedurave për përjashtimin e infrastrukturës kryesore të re, përfshirë termat dhe kushtet për paraqitjen e dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve në ERE.

3. Në këtë rregullore të gjitha termat janë përdorur sipas kuptimit të përshkruar në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, (këtu dhe më poshtë “Legjislacioni”) dhe do të aplikohet në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë procedurat e brendshme dhe organizimin e ERE-s në konsultim me Sekretariat

e Komunitetit të Energjisë (këtu dhe më poshtë “Sekretariati”).

KAPITULLI II
APLIKIMI PËR PËRJASHTIMIN

Neni 3

Aplikimi për përjashtimin

1. Infrastruktura kryesore e re e gazit, siç është interkonjektori midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Komunitetit të Energjisë, LNG dhe hapësirat e depozitimit mundet, që sipas kërkesës të përjashtohen nga ERE nga dispozitat e pikës 1, të nenit 16, pikës 5, të nenit 33, germat “dh” dhe “e”, të pikës 1, të neni 17 dhe nenet 36, 42, 63, 64 dhe 71, të legjislacionit, sipas kushteve të mëposhtme:

a) investimi duhet të rrisë konkurrencën në furnizimin me gaz natyror dhe të forcojë sigurinë e furnizimit;

b) niveli i rrezikut, bashkangjitur investimit, është i tillë që investimi të mos bëhet nëse nuk është dhënë përjashtimi;

c) infrastruktura duhet të jetë në pronësi të një personi i cili është i ndarë të paktën për sa i përket formës së tij ligjore nga operatorët e sistemit në sistemet e të cilëve do të ndërtohet infrastruktura;

d) tarifat u vendosen përdoruesve të asaj infrastrukture;

e) përjashtimi nuk e dëmton konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit natyror, ose funksionimin eficient të sistemit të rregulluar me të cilin është i lidhur infrastruktura.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet gjithashtu për rritjen e konsiderueshme të kapacitetit në infrastrukturat ekzistuese dhe për modifikimet e infrastrukturave të tilla që mundësojnë zhvillimin e burimeve të reja të furnizimit me gaz natyror.

3. ERE, sipas rastit, mund të vendosë mbi përjashtimin referuar pikave 1 dhe 2 të këtij neni, sipas kritereve të vendosura në këtë nen.



KAPITULLI III PARAQITJA E DOKUMENTEVE, TË DHËNAVE DHE INFORMACIONIT

Neni 4

Lista e dokumenteve, të dhënave dhe informacionit

1. Aplikuesi, së bashku me aplikimin me shkrim për përjashtimin e infrastrukturës kryesore të re, duhet të paraqesë në ERE dokumentet e mëposhtëm për të arsyetuar kërkesën për përjashtimin. Ky informacion duhet të përfshijë, por nuk duhet të kufizohet tek:

a) paraqitja e përshkrimit të infrastrukturës kryesore të re për të cilën është dhënë përjashtimi;

b) dispozitat nga legjislacioni nga të cilat kërkohet përjashtimi;

c) relacionin për pjesën e përjashtuar të infrastrukturës kryesore të re;

d) kohëzgjatjen e përjashtimit të kërkuar për çdo dispozitë nga germa “b”, e pikës 1, të këtij neni;

e) analiza tekniko-ekonomike e projektit:

i. studimi i fizibilitetit për infrastrukturën kryesore të re;

ii. rezultatet e testimit të tregut që vërtetojnë interesin e tregut në përputhje me nenin 78, pika 11, të legjislacionit;

iii. analiza e kriterëve të përjashtimit bazuar në të dhënat e projektit të infrastrukturës dhe testimit të tregut;

f) paraqitja e një propozimi për çmimin për përdorimin e infrastrukturës dhe evolucionin e tij gjatë kohëzgjatjes së përjashtimit, në rast se kërkohet përjashtim nga aksesit i rregulluar i palëve të treta (TPA);

g) të dhënat dhe informacioni për aplikuesin siç parashikuar në nenin 5, të kësaj rregulloreje.

2. Të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacioni që kërkohet sipas këtij neni duhet të paraqitet në ERE në shqip dhe në gjuhën angleze me shkrim dhe në mënyrë elektronike me *e-mail* dhe/ose me cd ose usb.

Neni 5

Të dhënat dhe informacioni mbi aplikuesin

1. Aplikuesi duhet të paraqesë në ERE të dhënat dhe informacionin më poshtë:

a) kopje të noterizuara të dokumenteve mbi përfshirjen dhe regjistrimin;

b) listën për licencat, lejet dhe/ose autorizimet e marra nga aplikuesi për veprimtaritë në sektorin e gazit natyror, të dhëna nga autoritetet e vendeve të tjera dhe kopje të noterizuara të këtyre licencave, lejeve dhe/ose autorizimeve;

c) listën e aksionerëve përfshirë informacionin në lidhje me aksionet dhe të drejtat e aksionerëve;

d) listën e shoqërive tregtare, të cilat janë në kontroll të drejtpërdrejtë ose jo nga shoqëria që po aplikon, po ashtu duke shpjeguar qartë mënyrën e kontrollit dhe të drejtat përkatëse të aplikuesit;

e) listën e shoqërive tregtare, të cilat kanë kontroll direkt ose jo tek aplikanti dhe shpjegojnë qartë mënyrën e kontrollit dhe të drejtat respektive të këtyre shoqërive;

f) listën e shoqërive të tjera tregtare që kanë lidhje (që do të thotë grupe shoqërisht që kanë lidhje), të cilat tregojnë mënyrën e marrëveshjeve të veçanta me aplikuesin;

2. Nëse më shumë se një shoqëri po aplikon për përjashtimin, të gjitha shoqëritë do të konsiderohen si aplikues për të dhënat dhe informacionin dhe secila prej tyre duhet ta paraqesë atë në ERE.

3. Në çdo kohë, gjatë periudhës së përjashtimit, ERE, dhe sipas rastit, sekretariati, mund t'i kërkojë aplikuesit dokumente shtesë, të dhëna dhe/ose informacion përkatës për përjashtimin.

4. Aplikuesi duhet të njoftojë ERE për çdo ndryshim të dokumentet e paraqitura, të të dhënat dhe/ose informacioni, menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se (5) pesë ditë pune, pasi ka ndodhur ndryshimi dhe duhet të paraqesë dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionin e ndryshuar.

5. Të gjithë dokumentet duhet të jenë kopje origjinale dhe/ose kopje të noterizuara.

6. Aplikanti duhet të sigurojë përjashtimet për kërkesat e vendosura në nenin 4, dhe të ky nen i cili në kohën e aplikimit nuk ka përfunduar.

7. Para se të vendoset për përjashtimin, ERE, në çdo kohë, mund të kërkojë informacion shtesë nga aplikuesi.



KAPITULLI IV PROCEDURA E PËRJASHTIMIT

Neni 6

Procedurat që aplikohen dhe përjashtimi

1. ERE duhet të vendosë mbi përjashtimin bazuar në nenin 78, të legjislacionit dhe procedurave të caktuara në këtë rregullore.

2. Në rastin kur infrastruktura në fjalë është me vendndodhje në një ose më shumë palë të Komunitetit të Energjisë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë duhet të paraqesë një opinion këshillues për ERE-n dhe autoritetin rregullator të një shteti tjetër anëtar të BE-së ose palën kontraktuese të Komunitetit të Energjisë të përfshirë, që mund të përdoret si bazë për vendimin e tyre mbi përjashtimin, brenda 2 (dy) muajve nga data kur kërkesa për përjashtimin është bërë nga autoritetet rregullatore.

3. Në rastin kur autoritetet rregullatore të përfshira bien dakord mbi kërkesën për përjashtimin, brenda 6 (gjashtë) muaj nga data kur është marrë nga autoriteti rregullator i fundit, ata duhet të informojnë në varësi të situatës, Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë mbi vendimin e tyre.

4. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë duhet të ushtrojë të gjitha detyrat që u janë ngarkuar autoriteteve rregullatore të shteteve anëtare të BE-së dhe palëve kontraktore të Komunitetit të Energjisë të përfshira te ky nen:

a) në rastin kur të gjitha autoritetet rregullatore të përfshira nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë në një marrëveshje, brenda një periudhe prej 6 (gjashtë) muaj nga data kur kërkesa për përjashtimin është marrë nga autoriteti rregullator i fundit;

b) sipas një kërkesë të përbashkët nga autoritetet rregullatore të përfshira.

5. Të gjithë autoritetet rregullatore të përfshira mund të kërkojnë së bashku që periudha referuar gërmës “a”, pika 6, të këtij neni, duhet të zgjatet deri në 3 (tre) muaj.

6. Pavarësisht pikës 3, të nenit 3, të rregullores, ERE mund të aplikojë te Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë për të paraqitur opinionin e tij mbi kërkesën për përjashtimin, me qëllim të vendimit zyrtar. Ky opinion do të publikohet së bashku me vendimin.

7. ERE duhet t'i paraqesë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe në varësi të situatës, Komisionit të BE-së, në rastin kur një shtet anëtar është i përfshirë, në kohë, një kopje të çdo kërkesë për përjashtimin ashtu si është marrë kërkesa. Vendimi do t'i njoftohet në kohë, nga ERE, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë së bashku me informacionin përkatës në lidhje me vendimin. Ky informacion duhet t'i paraqitet sekretariatit i plotë, që sekretariati të marrë një vendim të bazuar.

8. Brenda dy (2) muajve pas datës kur është marrë njoftimi, referuar pikës 2 të këtij neni, sekretariati do të shpërndajë opinionin në ERE dhe do ta ftojë këtë të fundit të ndryshojë ose të tërheqë vendimin për dhënien e përjashtimit. Kjo periudhë dymujore mund të zgjatet me një periudhë shtesë prej dy muaj në rastin kur kërkohet informacion tjetër nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Kjo periudhë shtesë fillon ditën pas marrjes së informacionit të plotë. Periudha fillestare prej dy muajsh mund të zgjatet me miratim të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe të ERE-s. Në mungesë të një opinionin nga Sekretariati, brenda periudhës së caktuar te ky dokument, mendohet se sekretariati nuk ka kundërshtime në lidhje me vendimin e ERE-s.

9. Kur informacioni i kërkuar, siç përcaktohet në pikën 3 të këtij neni, nuk është dhënë brenda periudhës së përcaktuar në kërkesë, do të konsiderohet se njoftimi i dërguar në përputhje me pikën 2 të këtij neni, do të tërhiqet me përjashtim të rastit kur ERE, para periudhës së përfundimit të afatit të përmendur në pikën 3, përmes një deklarate të arsyetuar, ka njoftuar sekretariatit që e konsideron njoftimin të plotë, ose periudha është zgjatuar me miratimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe ERE-s.

10. Brenda dy (2) muajve nga dita e marrjes së opinionit të sekretariatit, ERE do të marrë vendimin përfundimtar, lidhur me përjashtimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit, duke iu referuar në maksimum këtij opinionin. Vendimi i ERE-s dhe opinionin i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë do të publikohen së bashku.

11. Në rastin kur vendimi përfundimtar i ERE-s ndryshon nga opinionin i sekretariatit, ERE do të sigurojë dhe publikojë, së bashku me këtë vendim, relacionin në lidhje me vendimin e ndryshuar dhe duhet të informojë sekretariatit.



12. Vendimi përfundimtar i ERE-s mbi përjashtimin do të publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit të ERE-s.

Neni 7

Vendimi mbi përjashtimin

1. ERE do të miratojë një projektvendim mbi përjashtimin, brenda 60 ditëve pas aplikimit. Para marrjes së vendimit, ERE do të konsultohet me autoritetet rregullatore përkatëse dhe aplikuesit.

2. Përjashtimi mund të përfshijë të gjitha ose pjesë të, përkatësisht infrastrukturës së re, ose të infrastrukturës ekzistuese me kapacitet të shtuar në mënyrë të konsiderueshme ose modifikim të infrastrukturës ekzistuese.

3. Kur vendoset për dhënien e përjashtimit, do të merret në konsideratë, rast pas rasti, nevoja për të vendosur kushte në lidhje me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe aksesin jodiskriminues në interkonjektor. Kur vendoset në lidhje me kushtet në këtë pikë duhet të merren parasysh, veçanërisht, kohëzgjatja e kontratave, kapaciteti shtesë që do të ndërtohet ose modifikimi i kapacitetit ekzistues, periudha kohore e projektit dhe rrethanat në vend.

4. Kur jepet përjashtimi, ERE vendos për rregullat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe alokimin e kapacitetit. Rregullat kërkojnë që të gjithë përdoruesit e mundshëm të infrastrukturës të jenë të ftuar të tregojnë interesin e tyre për kapacitetin kontraktues përpara se të bëhet ndarja/alokimi i kapaciteteve në infrastrukturën e re, përfshirë ato për përdorim vetjak. ERE do të kërkojë që rregullat e menaxhimit të kongestionave të përfshijnë detyrimin për të ofruar një kapacitet të papërdorur në treg dhe do t'u kërkojë përdoruesve të infrastrukturës të kenë të drejtë të tregtojnë kapacitetet e tyre të kontraktuara në tregun sekondar. Në vlerësimin e kritereve të përmendura në germenat: "a", "b" dhe "d", të pikës 5 të këtij neni, ERE do të marrë në konsideratë rezultatet e kësaj procedure të alokimit të kapaciteteve.

5. Projektvendimi i përjashtimit, përfshirë kushtet e përmendura në pikën 4 të këtij neni, do të arsyetohet dhe publikohet në Fletoren Zyrtare. Pa zbuluar informacionin e ndjeshëm tregtar, vendimi duhet të përmbajë:

a) një arsyetim të detajuar mbi bazën e të cilit ERE dha ose refuzoi përjashtimin, së bashku me një referencë në pikën 1 të këtij neni, duke

përfshirë edhe dispozitat përkatëse mbi të cilat bazohet një vendim i tillë, përfshirë informacionin financiar që arsyeton nevojën e përjashtimit;

b) analizën e bërë për efekt konkurrence dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit si rezultat i përjashtimit;

c) arsyet për periudhën kohore dhe pjesa e kapacitetit total të infrastrukturës në fjalë të gazit për të cilën është dhënë përjashtimi;

ç) në rast se përjashtimi ka të bëjë me një interkonjektor, rezultati i konsultimit me vendet ose autoritetet rregullatore të përfshira;

d) kontributi i infrastrukturës, në lidhje me shumëllojshmërinë e furnizimit me gaz natyror.

KAPITULLI V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 8

Mbrojtja e informacionit konfidencial

1. Në rastet kur dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet, të paraqitura nga kërkuesi tek ERE ose te sekretariati, përmbajnë informacion konfidencial ose ndryshe informacion të ndjeshëm tregtar, aplikuesi duhet të tregojë qartë se cilat pjesë të dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacionit do të konsiderohen si konfidenciale ose informacion i ndjeshëm tregtar dhe të mos u zbulohen palëve të treta.

2. ERE ose sekretariati duhet të mbrojnë informacionet konfidenciale ose informacionin e ndjeshëm tregtar, nëse kërkohet nga aplikuesi dhe nuk do të ketë një detyrim të tillë nëse aplikuesi nuk e ka bërë kërkesën sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 9

Detyrimi

Personat, të cilët kryejnë shkelje të kësaj rregulloreje ose vendimeve përkatëse të miratuara nga ERE, do të jenë përgjegjës sipas legjislacionit.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Vendimi i ERE-s, sipas kësaj rregulloreje, mund të apelohej në gjykatën kompetente (Gjykata e Tiranës/Gjykata Administrative).



2. Pa ndikuar në pikën 1 të këtij neni, çdo mosmarrëveshje sipas kësaj rregulloreje mund të trajtohet në mënyrë miqësore përmes pajtimit dhe negociatave midis palëve. Nëse nuk gjendet një zgjidhje brenda 30 ditëve, palët në mosmarrëveshje mund të aplikojnë për asistencë pranë Qendrës së Komunitetit të Energjisë për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve dhe Negociatave.

Neni 11

Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s, në përputhje me “Rregullat për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”.

Neni 12

Dispozitat finale

1. Kjo rregullore i nënshtrohet rishikimit dhe ndryshimit nga Bordi i ERE-s, në përputhje me “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

2. Kjo rregullore do të botohet në faqen e internetit të ERE-s, pas miratimit dhe publikimit në Fletoren Zyrtare.

3. Interpretimi i kësaj rregulloreje do të sigurohet dhe bëhet publike nga ERE në përputhje me rregullat procedurale.

4. Këto rregulla hyjnë në fuqi datën kur ato miratohen nga ERE.

VENDIM

Nr. 74, datë 12.3.2021

MBI MIRATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE-s PËR PERIUDHËN 2021–2023

Në mbështetje të nenit 10, nenit 16 dhe nenit 18, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 25, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/7 prot., e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, për

miratimin e objektivave strategjikë të ERE-s për periudhën 2021–2023,

konstatoi se:

- Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 4, parashikon se ministria përgjegjëse për energjinë: “(pika 2, germa “a”) Harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë (pika 2, germa “b”), harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë”.

- Strategjia e hartuar e që paraqitet për miratim vjen në përshtatje të plotë me frymën e paketës së katërt rregullatore “Clean Energy package”, e cila ka në fokus të saj vendosjen e rregullave që e bëjnë më të lehtë për konsumatorin që të prodhojë dhe të shesë energji si vetëprodhues, të garantojë transparencë për të drejtat e konsumatorit dhe mundësi më të mira zgjedhjeje sa i përket shërbimit dhe çmimeve.

- Plani strategjik dyvjeçar i propozuar për miratim, përbëhet nga: misioni dhe objektivat e përgjithshëm, mbrojtja e konsumatorëve përmes ndërgjegjësimit dhe dhënia zë konsumatorit.

- **Transparenca dhe integriteti në veprimtarinë administrative**

ERE është një organ administrativ i pavarur, i cili në përputhje me ligjin për energjinë dhe gazin natyror, ushtron kompetencat me paanësi dhe transparencë.

Është parim i konsoliduar në veprimtarinë e ERE-s që ushtrimi i kompetencave rregullatore të përfshijë procedura të bazuara në pjesëmarrje, si përmes konsultimit të personave, ekspertëve të fushës ashtu edhe në drejtim të grupeve të gjëra të interesit. Sa më sipër, është vlerësuar si një aspekt i rëndësishëm i llogaridhënies duke informuar mbajtësit e interesave në treg në mënyrë adekuate dhe mbledhjen e mendimeve, opinioneve dhe propozimeve dhe duke i përfshirë ato sa më shumë që të jetë e mundur në procesin e vendimmarrjes brenda një kuadri rregullator të përcaktuar dhe



duke iu referuar parimit të transparencës dhe paanshmërisë së veprimtarisë rregulluese.

- ERE konsideron të vijoje bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse për energjinë përmes ekipeve të përbashkëta për një sërë objektivash, duke filluar nga reforma në tregun e shitjes me pakicë, roli i funksionimit të sistemeve/operatorëve.

- ERE, gjithashtu, do të bashkëveprojë rregullisht me institucione të tjera, të tillë si: Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në kuadër të bashkëpunimit për çështjet që lidhen me Zbatimin e masave të plota organizative dhe teknike të sigurisë kibernetike në sistemet e komunikimit dhe të informacionit, si dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për çështjet që lidhen me klientët në nevojë.

- Sa i përket zhvillimit të tregjeve gjithnjë e më efikas dhe të integruar të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në prioritetet e ERE-s, përfshihet edhe zhvillimi i një reforme tarifore nisur nga riorganizimi i tregut, për qëllim të së cilës parashikohet, analiza e problematikave të konstatuara pas miratimit të metodologjive dhe adresimi i zgjidhjeve përmes praktikave më të mira, realizimi i një studimi në mënyrë që të vlerësohen mundësitë që çojnë në uljen e kostove për konsumatorët dhe mbështesin tranzicionin drejt liberalizimit të plotë etj. Lidhur me realizimin e *market coupling* Shqipëri–Kosovë, ERE angazhohet të luaj një rol të rëndësishëm, duke aprovuar bashkëpunimin dhe marrëveshjet operacionale të propozuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe Bursa e energjisë.

- ERE do të vijoje e thelloje angazhimin me organizatat dhe institucionet evropiane, duke e konsideruar bashkëpunimin me to, si një ekspertizë të mirë, për të ndihmuar në sigurimin e rezultateve pozitive për konsumatorët.

- Në vijim do të miratohet edhe kalendari i veprimeve dhe strukturave përgjegjëse për implementimin e objektivave strategjikë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë objektivat strategjikë të ERE-s për periudhën 2021–2023 (bashkëlidhur).

2. Ngarkohet çdo strukturë e ERE-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË ERE-s PËR PERIUDHËN 2021–2023

Me këtë dokument, Enti Rregullator i Energjisë, në vijim ERE, adreson objektivat strategjikë dhe aspektet kryesore të veprimit për periudhën 2021–2023 në kuadër të dinamikës së zhvillimit të sektorit në kontekstin kombëtar, si dhe atë të integritimit rajonal.

KAPITULLI I

1. MISIONI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Veprimtaria e ERE-s në fushat objekt i rregullimit, drejtohet nga qëllimet e përgjithshme të përcaktuara sipas ligjeve nr. 43/2015 dhe atë nr. 102/2015. Në kuptim të këtyre ligjeve, ERE është përgjegjës për “*Rregullimin e sektorit të energjisë elektrike dhe atë të sektorit të gazit natyror*”. Rregullimi kryhet nga ana e ERE-s, përmes miratimit të akteve nënligjore normative apo individuale që rregullojnë veprimtarinë e subjekteve të sektorit. Rregullimi, përfshin edhe vendosjen në tregun e rregulluar të një sistemi tarifar të besueshëm, transparent e të bazuar në kriteret e paracaktuara në ligj, duke mbajtur në konsideratë interesat e konsumatorëve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore që sigurojnë një furnizim të vazhdueshëm kundrejt kostove të drejta dhe të argumentuara. Në përcaktimin e tarifave, ERE duhet gjithashtu “*të harmonizojë objektivat ekonomiko-financiarë*” të subjekteve që ushtrojnë aktivitet të rregulluar, me objektivat e përgjithshëm të sektorit në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit apo politikës shtetërore lidhur me zhvillimet sektoriale.

Një aspekt tjetër i rregullimit përfshin funksione monitoruese përmes kontrollit të të licencuarve dhe vendosjes së masave që synojnë të garantojnë pajtueshmërinë e operimit të të licencuarit me rregullat në fuqi. Qëllimi është të mbrojmë dhe të kemi një impakt pozitiv për të gjithë pjesëmarrësit e



tregut të energjisë elektrike apo gazit natyror. Për këtë fokusohemi në punën për të promovuar sigurinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë për të tashmen, po ashtu dhe të ardhmen. Për të realizuar këtë objektiv ushtrojmë rregullimin dhe implementimin e skemave mbështetëse, si dhe mbikëqyrjen e tregut. Në punën e saj, ERE bashkëpunon me aktorët kryesorë të sektorit, duke mbajtur të pa cenuar pavarësinë institucionale të Entit si një qëllim i shenjtë i punës së rregullatorit. Sa më sipër kryhet brenda një kornize ligjore të përcaktuar në ligjet që rregullojnë veprimtarinë e ERE-s në sektorin e energjisë elektrike apo dhe atë të gazit natyror.

Ndër objektivat kryesorë të ERE-s është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, në lidhje me shërbimet e rregulluara të ofruara nga operatorët e sektorit. ERE kryen funksionet e saj në vlerësim të çuarjes përpara të objektivave të përcaktuar në ligj, duke promovuar konkurrencë efektive dhe transparente midis pjesëmarrësve të tregut. Në metodologjinë e punës së ERE-s për të kryer funksionet e saj për qëllime të promovimit të konkurrencës, ERE mban në konsideratë shkallën në të cilën interesat e konsumatorëve duhet të mbrohen si rrjedhojë e ushtrimit të këtyre funksioneve, si dhe nëse ato do të promovojnë ose jo transparencën në veprimtarinë në treg.

Në përcaktimin e objektivave strategjikë, ERE bazohet në realizimin e qëllimeve të ligjeve të sipërcituara dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, për garantimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët si një shërbim i domosdoshëm në terma ekonomikë, teknikë e mjedisorë, të shtrirë në të gjithë vendin, dhe i harmonizuar me parimet e objektivat strategjikë të vendit.

KAPITULLI II

2. KUADRI STRATEGJIK

Kuadri strategjik paraqitet më poshtë i orientuar në dy drejtime kryesore:

- objektivat strategjikë, në të gjithë aktivitetet e rregulluara të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror;
- planet e veprimeve të cilat përshkruajnë masat kryesore që ERE synon të përdorë për realizimin e secilit objektiv strategjik në funksion edhe të një afati kohor dhe me veprime konkrete që afektojnë pozitivisht aktivitetet në këto fusha.

Objektivat strategjikë dhe linjat e veprimit nuk e shpëtojnë kuadrin e veprimtarive që ERE do të duhet të ndërmarrë për rregullimin dhe kontrollin e sektorëve në fushën e saj të përgjegjësisë, por ato përfaqësojnë pikat kryesore në të cilat synohet të ndërhyhet me përparësi, gjithashtu në kontekstin e zhvillimeve sektoriale në vend.

KAPITULLI III

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË PËR VITET 2021–2023

3.1 Mbrojtja e konsumatorëve përmes ndërgjegjësimit

Prioriteti kryesor i rregullatorëve është “Mbrojtja e interesave të konsumatorëve” dhe, pikërisht, konsumatorët janë në thelbin e strategjisë së ERE-s për 2 vitet pasardhëse. Në shoqërinë e informacionit aspekte të rëndësishme të mbrojtjes konsumatore janë jo vetëm tarifa të arsyeshme që reflektojnë kostot e argumentuara, por edhe shërbim në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në fushën e informacionit, aspekte të rëndësishme të mbrojtjes konsumatore janë jo vetëm tarifa të arsyeshme, që reflektojnë kostot e argumentuara, por edhe shërbim në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve ofruese dhe marrëse të këtij shërbimi.

Në kontekstin e përgjithshëm të objektivave dhe veprimeve të përshkruara më tej, inovacioni dhe zhvillimi teknologjik (nga të cilat digjitalizimi përfaqëson një ndër elementët kyç) përbëjnë faktorë të rëndësishëm të evolucionit, i lidhur ngushtë me benefitet që vijnë nga përdorimi i teknologjisë, por i shoqëruar paralelisht edhe me rrezikun e mundshëm të kostove ekstra të krijuara nga ky përdorim teknologjik, çka kërkon vëmendje të vazhdueshme ndaj kostove të shërbimeve.

Në aspektin e kuadrit rregullator, ERE është angazhuar për të konsoliduar koherencën e mekanizmeve rregullatore në aktivitete të ndryshme të fushës së përgjegjësisë së tij. Brenda këtij kuadri, konsumatori merr një rol vendimtar e në rritje. Në këtë kontekst, ndërgjegjësimi i konsumatorit për t'u bërë klient i aftë në vlerësimin e ofertave, kuptimin e drejtë të mekanizmeve të tregut, deri në mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në shërbimet e lidhura me furnizimin, siç është rasti i vetëprodhuesve që prodhojnë dhe konsumojnë vetë energji, merr një rëndësi të veçantë. Ky është



një aspekt tjetër i rolit të konsumatorit dhe spektrit të të drejtave e mundësisë së zgjedhjes prej tij jo vetëm të furnizuesit të energjisë, por edhe të kryerjes aktiv të funksionit të prodhuesit/konsumator të energjisë elektrike, duke minimizuar kostot individuale për sigurimin e energjisë elektrike dhe, pse jo, rritjes së rolit të tij në treg. Në këtë aspekt, është me mjaft rëndësi ndërgjegjësimi i konsumatorit për mekanizmat e ndryshëm rregullatorë, por edhe rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me rolin e tyre të konsumit, në kuadër të lehtësirave që krijojnë proceset e hapjes së tregut në sektor. Nga ana tjetër, rregullimi jo vetëm që duhet të reflektojë një politikë të qëndrueshme që lejon konsumatorin të bëjë vlerësime, por nga ana tjetër duhet të harmonizojë nevojën për investime në teknologjinë e informacionit me vlerësimin e kujdesshëm të kostove të lidhura me investimet në sektor.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i objektivave që ERE merr në kuadër të rregullimit, por edhe integritetit të praktikave bashkëkohore të përdorimit të energjisë elektrike, është ai që lidhet me hapjen e diskutimit publik, si dhe kryerjes së analizave konstatuese mbi impaktin dhe eficiencën e përdorimit të burimeve të tjera të energjisë, si një alternativë ndaj përdorimit të energjisë elektrike me qëllim uljen e impaktit që kjo e fundit ka në mjedis. Inovacionet teknologjike gjithmonë e më shumë po ecin në drejtim të maksimizimit të eficiencës për sigurimin e shërbimeve me impakt të ulët në mjedis e kosto më të ulëta. I tillë, por jo i vetëm është edhe përdorimi i energjisë elektrike si një burim energjie për mjetet lëvizëse të transportit (taksitë, makinat vetjake apo edhe transporti publik).

Energjia është një mall me kosto, e në varësi të të ardhurave të një familjeje, e nevojës për përdorimin e energjisë elektrike, është i një rëndësie të veçantë, sensibilizimi i konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike. Vendosija e urave të bashkëpunimit mes ERE-s dhe agjencive për eficiencën e energjisë elektrike me qëllim sensibilizimin e konsumatorit dhe rritjen e ndërgjegjes kolektive mbi rëndësinë e përdorimit të energjisë elektrike si një produkt i çmuar, i cili nuk duhet të përdoret me efikasitet dhe eficiencë, do të jetë ndër targetat e punës së ERE-s përgjatë trevjeçarit në vijim.

3.2 Dhënia zë konsumatorit

ERE, në përputhje me objektivat e përcaktuar në ligj, synon të mbështesë dhe promovojë kalimin nga një konsumator pasiv, subjekt i tarifave të rregulluara akteve rregullatore, në një pjesëmarrës aktiv të tregut të energjisë. Hapi i parë në këtë drejtim është duke i siguruar konsumatorit mjete për të kuptuar më mirë nevojat e veta në terma cilësorë, në mënyrë që të mund të funksionojë koncepti i pjesëmarrjes aktive në treg. Një nga mekanizmat që mund të përdoren për këtë qëllim është fokusimi i punës së ERE-s në 3-vjeçarin në vijim, në shfrytëzimin më të mirë të mjeteve të informacionit, organizimit të trajnimeve apo tryezave informuese, vënien në eficiencë të numrit pa pagesë në shërbim të konsumatorit, si dhe transparencës sa i përket ligjbërjes në favor të konsumatorëve. Këta mekanizma do t'i shërbejnë ERE edhe në funksion të adresimit, përmes kuptimit të problematikave apo barrierave që konsumatorët konstatojnë dhe arrijnë të vlerësojnë.

3.3 Ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe transparenca në vlerësim të shërbimit

Ndërhyrjet e rregullatorit lidhen kryesisht me zhvillimin dhe përditësimin e një sistemi të menaxhimit dhe trajtimit të ankesave, dhënies së informacionit të saktë e të shpejtë, në kuadër të mundësive të reja teknologjike, që mundësojnë trajtimin në një kohë sa më të shkurtër e me mjete më të thjeshta. Lehtësimin e aksesit për shërbimet e kërkuara në kuadër të zgjedhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) si një mjet për zgjidhjen e shpejtë të problematikave që normalisht kërkojnë më shumë kohë dhe kosto përmes zgjidhjeve gjyqësore.

Për këtë qëllim, me mjaft rëndësi është edhe vendosja e protokolleve të bashkëpunimit me organizatat e shoqatave që kanë në fokus mbrojtjen e konsumatorëve apo njësitë përgjegjëse në shërbim të konsumatorit pranë pushtetit lokal apo qendror.

3.4 Forcimi i mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë

Ligji “Për sektorin e energjisë elektrike” ka adresuar në mënyrë të veçantë mbrojtjen e klientëve në nevojë, në kuadër të sigurimit të një të drejte thelbësore e shumë të rëndësishme, siç është e drejta për të pasur energji elektrike. Ky ligj, i cili përcakton ndër objektivat e ERE-s, mbrojtjen e klientëve në nevojë, ka parashikuar, veç të tjerave, detyrimin për furnizuesin e shërbimit universal që



të furnizojë në mënyrë të pandërprerë klientët në nevojë, duke respektuar kushtet e përcaktuara në ligj, si dhe kushtet e veçanta që duhen marrë në konsideratë nga ana e ERE-s për të garantuar mbrojtjen e atyre klientëve të energjisë që kanë përfituar këtë status, mbështetur në kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë, të përcaktuar në aktet ligjore për këtë qëllim.

Energjia elektrike është një shërbim jetësor dhe thelbësor që ndikon në mirëqenien dhe cilësinë e jetës së njerëzve dhe, si të tillë, ERE vlerëson se, një aspekt i rëndësishëm i mirëfunksionimit të tregut lidhet me përmbushjen e nevojave specifike për furnizimin me energji elektrike të kategorive të konsumatorëve në rrethana të caktuara. Për këtë qëllim ERE konsideron hartimin e politikave të qarta rregullatore për të adresuar të gjitha sfidat dhe pengesat që lidhen me implementimin e politikave në mbrojtje të konsumatorit në nevojë në sektorin e energjisë elektrike si një target të domosdoshëm për t'u arritur gjatë trevjeçarit të ardhshëm.

Mbështetja dhe mbrojtja e konsumatorëve është një prioritet kyç i lidhur me përgjegjësitë e Entit. Vizioni është që të mundësojmë një treg të energjisë për të gjithë konsumatorët duke përfshirë edhe konsumatorët në nevojë. Puna dhe detyrat e ERE-s në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë do të kërkojë një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe aktiv me institucionet përgjegjëse për politikën e mbrojtjes së konsumatorëve në tërësi. Megjithatë ligji nuk ia adreson ERE përcaktimin e konsumatorëve në nevojë dhe kriteret e përfitimit të statusit të klientit në nevojë, në rolin e tij si rregullator i sektorit, roli i ERE-s është tejet i rëndësishëm në krijimin e kushteve për mundësinë e furnizimit të tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe me cilësi.

Aktet nënligjore të miratuara nga ERE, kanë adresuar rrethanat e ndërprerjes së energjisë elektrike për klientët në nevojë që rezultojnë debitorë. Në vijim, në fokus të punës së ERE mbetet ndërmarrja e aktiviteteve të pajtueshmërisë dhe zbatimit për të siguruar që të licencuarit që ofrojnë shërbim furnizimi, të kenë vëmendjen e nevojshme dhe kujdesin që aktiviteti i tyre të jetë në përputhje me konceptet e mbrojtjes të konsumatorëve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

KAPITULLI IV PLANI I VEPRIMEVE

4.1 Aktivizimi i konsumatorit

Në kuadër të bashkëpunimit me shoqatat dhe organizatat, që në objekt të veprimtarisë së tyre kanë mbrojtjen e konsumatorëve do t'i kushtohet vëmendje e veçantë promovimit të transparencës e qartësisë në dialogun me konsumatorët, duke përmirësuar të gjitha kanalet aktuale të komunikimit nga ana e ERE-s, që lejojnë një mënyrë më efektive për përhapjen e njohurive për të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve e që forcojnë shkallën e tyre të besimit, nëpërmjet vendosjes së një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe inovative me një audiencë sa më të gjerë duke shfrytëzuar nga njëra anë, mundësitë teknologjike, por duke vijuar me mjetet tradicionale, për ata konsumatore që kanë nevojë për të.

Zhvillimi i një Portali të Konsumatorit, i cili të jetë aktiv e në dispozicion të këtij të fundit, në përputhje dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe që ofron shërbim mbi të dhënat historike të konsumit të tij përmes Sistemit të Informacionit të Integruar me Operatorin përgjegjës për regjistrimin e konsumit të energjisë, të klientëve.

Realizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere që synojnë të përmirësojnë ndërgjegjësimin e konsumatorit/përdoruesit mbi funksionimin dhe rregullimin në fushat e kompetencës së ERE-s.

4.2 Ndërgjegjësimi për konsumatorët dhe transparencë për vlerësim të shërbimit

Veprimet për qëllim të këtij objekti, përfshijnë ndjekjen e praktikave më të mira ndërkombëtare në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për të ndihmuar në zgjidhjen e tyre. Një analizë e praktikave rajonale do t'i shërbente përditësimit të këtyre rregullave në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Kjo analizë do të përfshijë, ndër të tjera, studimin mbi përmirësimin e procedurave ekzistuese të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, krijimit të një strategjie për të mbështetur një komunikim efektiv duke u angazhuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe të licencuarve, në mënyrë interaktive me ERE-n dhe këtyre të fundit.

Qasja rregullatore për tregun e energjisë është sigurimi se opinioni i konsumatorëve apo dhe nevojat e tyre aktuale dhe të ardhshme janë marrë



në konsideratë në çdo rast që ka pasur apo ka nevojë për rregullim.

Për këtë qëllim praktikant rregullatore do të vijojnë të përfshijnë zhvillimin e seancave dëgjimore dhe konsultimeve mes palëve, për një gjykim të drejtë të problematikave të ngritura dhe zgjidhjeve respektive të tyre.

Furnizimi i energjisë konsiston kryesisht në ofrimin e shërbimit në mënyrë cilësore dhe me standarde të tij. Për këtë qëllim, ERE do të përgatisë treguesit e matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim.

Këta tregues do të përcaktojnë nivelin e kënaqësisë së klientit ndaj shërbimit të ofruar, parë në këndvështrimin e të gjitha aspekteve të marrëdhënies së tij me ofruesin e shërbimit. Sa më sipër lidhet me kushtet e garantimit dhe zbatimit të një kontrate furnizimi dhe më tej aspekte të tilla si vlerësimi konsumator mbi procedurat dhe afatet për lidhjen e një kontrate, ndryshimin e furnizuesit, emetimin e faturave në afat, trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave nga ana e ofruesit të shërbimit dhe garantimi i aksesit në të dhënat vetjake që lidhen me konsumin e energjisë.

Paralelisht do të vendosen dhe monitorohen rregullisht standardet e cilësisë së shërbimit. Për këtë qëllim do të vijohet me përcaktimin e kritereve të standardeve të cilësisë në përputhje me rregulloren për cilësinë e shërbimit, si dhe përditësimin e tyre periodik mbështetur në të dhënat e gjeneruara përgjatë një viti kalendarik, si dhe pritshmërinë e vlerësimit të shërbimit të cilësisë së shërbimit, të investimeve të propozuara dhe miratuara për ofruesit e shërbimit publik, kjo bazuar dhe në praktikant më të mira ndërkombëtare.

Po ashtu do të zhvillohet dhe çdo formë tjetër përfshirje për qëllime të marrjes së opinionit të konsumatorëve për të kuptuar më mirë objektivat e tyre në të ardhmen dhe atë që konsumatorët presin nga ERE.

4.3 Forcimi i mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë

Adresimi i zgjidhjeve për një furnizim të qëndrueshëm të konsumatorëve në nevojë kërkon veprime të përbashkëta ndërmjet qeverisë, rregullatorit dhe pjesëmarrësve të tjerë të sektorit të energjisë. Vulnerabiliteti është një çështje komplekse për të trajtuar ku të gjithë politikëbërësit, grupet e interesit, organizmat apo

shoqatat me fokus konsumatorin, si dhe ofruesit e shërbimeve duhet të bashkëpunojnë për të adresuar sfidat që lidhen me këtë kategori.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për politikën e mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë. Për këtë qëllim do të vijohet komunikimi me institucionet përgjegjëse për vendosjen e kritereve të përcaktimit të klientëve në nevojë.

Në përputhje me zhvillimet e këtyre politikave synohet përditësimi i akteve rregullatore që lidhet me sigurimin me cilësi të furnizimit me energji elektrike të këtyre konsumatorëve. Nisur nga praktikant më të mira rajonale dhe më gjerë, nga ERE do të përgatiten edhe propozimet e nevojshme për të shtyrë përpara iniciativat ligjore, për rregullimin e kuadrit ligjor plotësues për këtë kategori, në rolin e një aktori më aktiv në drejtim të kompetencave rregulluese për këtë kategori konsumatorësh.

Për këtë qëllim, kryerja e një studimi lidhur me politikant më të mira rregulluese për mbrojtjen e klientëve në nevojë në vendet e BE-së, do të shërbejë për të propozuar pranë institucioneve kompetente ndryshimet e nevojshme në aktet ligjore dhe nënligjore, përfshirë ndryshimet e nevojshme me aktet rregullatore të ERE-s. Sfidë më vete në drejtim të politikave të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë është aspekti i shmangies së ndër-subvencioneve dhe rolit që duhet të luajmë për rishpërndarjen e kostove në grupe të ndryshme të konsumatorëve, apo edhe në nevojën për aplikimin e politikave që lidhen me eficiencën në energji.

Në kuadër të studimit për ndryshimet e nevojshme në kuadrin rregullator po ashtu vëmendje e veçantë do t'i kushtohet dhe aspekteve që lidhen me barrierat me të cilat përballen këta konsumatorë në krahasim me klientët e tjerë. Eksperiencia ka treguar se konsumatorët në nevojë mund ndihen të paafte për të marrë vendime që lidhen me furnizimin në energji. Studimi i barrierave mund të përfshijë bashkëpunimin edhe me organet përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit apo me shoqatat e konsumatorit. Klientëve në nevojë duhet t'u sigurohet mbështetje edhe nga organet përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit apo shoqatat e konsumatorëve, si edhe ndërgjësimi i të licencuarve apo pjesëtarëve të tregut për hartimin e politikave brenda kompanive



lidhur me mënyrën se si ata projektojnë dhe realizojnë shërbimet e tyre për klientët në nevojë.

Hartimi i një Programi të Mbrojtjes së Konsumatorëve do të shërbente për të siguruar njohuri të mjaftueshme dhe të vazhdueshme në politikat mbështetëse për konsumatorët.

KAPITULLI V

5.1 ZHVILLIMI I TREGJEVE TË ENERGISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR GJITHNJË E MË EFIKAS DHE TË INTEGRUAR

ERE do të përqendrohet në punën e saj, ndër të tjera, në promovimin e konkurrencës dhe inovacionit me qëllim uljen e çmimeve dhe në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve.

Mbështetur kjo, në sa më poshtë:

- parimi i hapjes së tregut – përdorimi i mekanizmave të tregut kudo që është e mundur për të përfituar plotësisht nga inovacioni dhe konkurrenca;

- parimi i koherencës – rregullim efikas dhe i përgjegjshëm ku është e mundur që shfrytëzon mundësitë e mëdha të ekonomisë digjitale (*smart*); dhe

- parimi i shpërndarjes së drejtë – konsumatorët e të gjitha llojeve duhet të paguajnë një pjesë të drejtë të kostove të sistemit në përputhje me shërbimin që marrin dhe kostot që shkaktojnë.

Në këtë drejtim prioritetet e ERE-s gjatë kësaj periudhe do të jenë:

- Zhvillimi i një reforme tarifore nisur nga riorganizimi dhe hapja e tregut.

- Për këtë qëllim është e nevojshme një analizë e plotë e problematikave të konstatuara pas miratimit të metodologjive dhe adresimi i zgjidhjeve përmes praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim. Për këtë qëllim, do të përdoren raportet, studimet e kryera nga donatorët apo dhe organizatat rajonale ku ERE aderon.

- Realizimi i një studimi në mënyrë që të vlerësohen mundësitë që çojnë në uljen e kostove për konsumatorët dhe mbështesin tranzicionin drejt liberalizimit të plotë.

- Analizë të detajuar mbi një vlerësim se si rregullimi ndikon në grupe të ndryshme të konsumatorëve; dhe

- Zhvillimi i mënyrave efektive të vendosjes së bazës së rregulluar të aseteve (RAB).

Nevoja për të lejuar një pjesëmarrje gjithnjë e më të gjerë aktive të pjesëmarrësve të tregut me transaksione të orientuara në tregun e ditës në avancë dhe *intraday* do të duhet të gjejnë zgjidhje, në mënyrë që të përfshijnë kostot e sistemit në lidhje me shërbimet e ofruara në treg.

Objekti i kësaj strategjie synon të sigurojë që politikat rregullatore, mekanizmat dhe praktikat operacionale do të zbatohen në përputhje me praktikën më të mira rregullatore dhe dispozitat e zbatueshme të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë, si dhe kodet e zbatueshme të rregullit.

Enti Rregullator i Energjisë miraton rregullat dhe rregulloret e nevojshme për të përmbushur detyrimet sipas ligjit për sektorin e gazit natyror të vitit 2015, i ndryshuar. ERE lëshon licencat për operimin e aktiviteteve në fushën e gazit natyror. Përcakton tarifat dhe çmimet në përputhje me kushtet e ligjit për sektorin e gazit natyror të vitit 2015. Monitoron, kontrollon dhe siguron pajtueshmërinë me kushtet, ligjet dhe licencat.

Siguron mbrojtjen e konsumatorit në lidhje me tarifat.

Sa i përket sektorit të gazit natyror, ERE ka marrë masat e nevojshme për draftimin e kuadrit të plotë ligjor që faciliton operimin në këtë sektor, pavarësisht se aktiviteti në sektorin e gazit në Shqipëri është në stadin foshnjor. Në objektivat afatgjatë 3-vjeçarë të ERE do të jenë:

1. Identifikimi i nevojës dhe kërkesave për gaz dhe skenarët e mundshëm për të mundësuar furnizimin me gaz të konsumatorit shqiptar, qoftë ai familjar apo edhe jo familjar.

2. Studimi i Politikave të çmimeve, tarifave dhe implementimit të rregulloreve të gazit të miratuara nga ERE dhe jo vetëm.

3. Zhvillimin e njohurive dhe aftësive brenda Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për të identifikuar në kohe mundësinë për rregullim dhe ndërhyrje aty ku është nevoja.

4. Adresimi i çështjeve që lidhen me kuadrin institucional kombëtar të sektorit të gazit dhe dhënia e rekomandimeve për zhvillimin e mëtejshëm të tij, si dhe mbështetja në zhvillimin e njohurive në fushën e gazit dhe aftësimin profesional të punonjësve të ERE-s nëpërmjet trajnimeve të targetuara për specifikat e zhvillimit të këtij sektori në Shqipëri.

5. Vlerësimi i rregullit ekzistues të gazit në Shqipëri dhe dhënia e rekomandimeve për integrimin e tij të



mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit.

5.2 Integrimi rajonal

Memorandumi i Mirëkuptimit të WB6, i nënshkruar më 27 prill 2016, në Vjenë, nga 6 vende përfshirë Shqipërinë dhe Kosovën. Në kuadër të këtij memorandum i nënshkruar me kompetencat e tyre ligjore, rregullatorët do të përdorin autoritetet e tyre, për:

- të hequr pengesat rregullatore dhe monitorojnë zhvillimin e vazhdueshëm në nivel teknik dhe rregullator;

- të miratojë procedurë të përbashkët dhe efikase të vendimarrjes, që do të ndihmojnë në krijimin e mundshëm dhe të duhur të Bursës (PX).

Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, i ndryshuar, përcakton ERE-n në cilësinë e Autoritetit përgjegjës për garantimin e promovimit të konkurrencës dhe efikasitetin në sektor. Modeli i Tregut, i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016, thekson, ndër të tjera, se Shqipëria është e angazhuar të zbatojë një sërë masash afatshkurtra, në kuadrin e procesit të Berlinit (Ballkani Perëndimor 6). Modeli i tregut synon të mbështesë zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadrin e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe rregulloret përkatëse. Ky model synon, ndër të tjera, të sigurojë një strukturë të qëndrueshme dhe të krijojë kushtet për integrimin e mëtejshëm rajonal, midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje. Mekanizmi i Bashkimit të Tregut është pjesë e projektit evropian për krijimin e Tregut të Brendshëm të Energjisë për të rritur efikasitetin e tij.

Aktualisht nën asistencën dhe mbështetjen e USAID-it janë hedhur hapa të rëndësishëm në kuadër të bashkimit të tregjeve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Në vijim puna e rregullatorit do të fokusohet, ndër të tjera, në:

- kontrollin dhe azhurnimin e legjislacionit në fuqi nëse ka pengesa ligjore në procesin e bashkimit të tregut, përfshirë bashkëpunimin për licencimin në tregjet reciproke, operimin e pjesëmarrësve në treg, alokimin e kapacitetit ndërkufitar përmes ankandit eksplisit apo dhe zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim;

- mbështetjen për zbatimin e rregullave teknike për operimin e tregjeve të përbashkëta nga të dy TSO-të;

- përpilimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve midis OST-ve dhe rregullatorëve për implementimin e bashkimit të tregjeve;

- nominimin e NEMO-s për operimin e të dy tregjeve në përpunime me kushtet e nominimit, si dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

5.3 Forcimi i aksesit në informacion për funksionimin korrekt të proceseve të tregut

ERE në përpunime me kompetencat rregullatore do të fokusojë punën e saj për të mbledhur dhe menaxhuar flukset në rritje të të dhënave që bëhen të disponueshme, dhe në mënyrë më të dukshme të bazojë metodat e saj analitike dhe vendimarrjen në baze të këtyre të dhënave. Përdorimi më i mirë i të dhënave do të mundësojë që ERE të veprojë në mënyrë më efikase dhe transparente.

Në këtë kontekst, ERE synon të forcojë angazhimin e saj për integrimin e tregut kombëtar të energjisë në kontekstin rajonal, në koordinim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse për energjinë, operatorët e rrjetit dhe, rregullatorët fqinje, duke siguruar transparencën e nevojshme ndaj palëve të interesuara.

Evolucioni i veprimtarisë së operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe asaj të shpërndarjes, si dhe marrëdhënia e tyre me përdoruesit, gjithashtu, do të analizohen në kontekstin e shmangies së barrierave dhe në adresimin në kuadër të miratimit të investimeve, që i shërbejnë cilësisë së shërbimit, por edhe sigurisë së sistemit, i cili në të njëjtën kohë ka përfitimet e veta nga digjitalizimi, por njëkohësisht është edhe vulnerabël për mbrojtjen nga sulmet kibernetike. Në këtë kontekst ERE do të fokusohet edhe në analizën e nivelit të implementimit të rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike nga operatorët, si dhe shtrirjen e saj dhe në sektorin e gazit natyror.

Krahas rregullimit klasik përmes mbikëqyrjes apo përmes përpunimit të të dhënave, është e nevojshme që, në mënyrë progresive të forcohen aktivitetet për monitorimin e sjelljes së operatorëve të tregut, veçanërisht në zbatimin e rregullores evropiane REMIT, me qëllim garantimin e kushteve transparente konkurruese dhe luftimin dhe parandalimin e sjelljes abuzive duke identifikuar menjëherë çdo nevojë për të përshtatur



vetë rregulloren (edhe për qëllimet e sigurisë së sistemit), si dhe për çdo raport mbi konkurrencën në treg.

Implementimi i REMIT do të bazohet në kuadrin ligjor dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të orientuar, në:

- detyrimin për të publikuar informacione të brendshme;
- ndalimin e abuzimit të tregut (tregtimi i brendshëm dhe manipulimi i tregut);
- monitorimin e tregut (regjistrimi i pjesëmarrësve në treg);
- mekanizmin e raportimit të detajuar, mbledhja e të dhënave;
- kompetencat hetimore dhe të zbatimit të penaliteteve të rregullatorit;
- aspekte të tjerë në lidhje me mbrojtjen dhe besueshmërinë e të dhënave;
- lista e kontratave dhe të dhënave që do të raportohen;
- palët përgjegjëse dhe afatet;
- udhëzime, rekomandime;
- njohja e palëve me detyrimet e zbatimit të kësaj rregulloreje;
- bashkëveprimi ndër rajonal për zbatimin e saj në rajon e më gjerë.

Pikërisht politikat rregullatore edhe në vijim do të kenë për qëllim që të sigurojnë qëndrueshmëri ligjore dhe rregullatore për të menaxhuar potencialin për praktika abuzive që dëmtojnë në mënyrë të padrejtë tregun.

Brenda vitit 2021 synohet të realizohet procesi i konsultimit të draftit të rregullave për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT), të cilat do të hyjnë në fuqi dhe do të jenë të detyrueshme për t'u zbatuar brenda tremujorit të parë të vitit 2021.

KAPITULLI VI

PLANI I VEPRIMEVE PËR ZHVILLIMIN E TREGJEVE

6.1 Racionalizimi dhe thjeshtimi i rrjedhës të informacionit për të vlerësuar funksionimin e proceseve të tregut

Qëllimi është të përfundojnë reformat që synojnë racionalizimin dhe thjeshtimin e flukseve të informacionit, i cili garanton funksionimin e duhur të tregjeve dhe marrja e informacionit sa më të thjeshtuar për konsumatorin. Në këtë kontekst,

është e nevojshme të përfundohen reformat e proceseve tregtare që kanë të bëjnë me të drejtën për ndryshimin e furnizimit dhe administrimit të procedurave të ndërhyrjes në rast të borxheve midis palëve, si dhe ndërhyrjet rregullatore në fushën e menaxhimit të të dhënave në lidhje me përdorimin e të dhënave të klientëve fundorë të përpunuara nga operatorët e rjetit.

Për këtë do të analizohen të dhënat lidhur me detyrimet e raportimit, metodat dhe kohën e vënies së tyre në dispozicion, përdorimi i të dhënave për palët e interesuara dhe, në veçanti, për pjesëmarrësit e tregut. Në këtë kontekst, në përputhje me gjetjet gjatë vitit 2021, në vijim në vitin 2023 do të përpunohen edhe propozimet për ndryshimet e nevojshme në aktet rregullatore. Sa më sipër do të jetë produkt i vlerësimit të kornizës rregullatore që identifikon çdo pengesë në legjislacionin primar dhe atë sekondar për të vendosur mbi ndryshimet e mundshme atje ku vlerësohet e nevojshme.

Në po këtë prizëm, rregullatori do të shërbejë dhe si një ndërfaqe për dhënien e informacionit të nevojshëm për konsumatorët dhe mundësitë që ofrojnë furnizuesit në mënyrë që konsumatori të ketë një panoramë të qartë të mundësive që i ofrohen, përfshirë këtu çmimet dhe cilësia me të cilën këto shërbime ofrohen, si dhe detyrimet që ka ndaj kontratës së furnizimit me ofruesit e këtij shërbimi.

6.2 Realizimi i bashkimit të tregjeve Shqipëri–Kosovë

Bashkimi i tregut midis Shqipërisë dhe Kosovës filloi nën një qasje vullnetare. Qeveritë e të dyja vendeve janë përfshirë që në fillim për të mbështetur projektin. Rregullatorët do të luajnë një rol të rëndësishëm duke nxitur marrëveshjet e bashkëpunimit dhe marrëveshjet operationale të propozuara nga ana e TSO-ve, OST-së dhe PX-së.

Gjithashtu do të jetë në fokus, ndër të tjera, dhe:

- identifikimi se cilat pjesë të CACM mund të transpozohen në kornizën ligjore aktuale;
- kontrolli nëse ka pengesa ligjore në legjislacionin kombëtar që pengojnë ose vonojnë bashkimin e tregjeve;
- OST-ja dhe PX-ja janë përgjegjëse për zbatimin e iniciativës dhe trajtimin e fazës operationale.

Më tej do të punohet në drejtim të zgjerimit të integritetit duke ftuar rregullatorët e tjerë të

Ballkanit për t'u bashkuar në projektet në kaudër të WB6.

6.3 Forcimi i aksesit në informacion për funksionimin korrekt të proceseve të tregut

ERE gjithmonë ka vlerësuar aksesin në informacion dhe transparencën si kritike për arritjen e misionit dhe qëllimit të saj, politikë e cila qëndron në themel të praktikave të vendimmarrjes. ERE ka funksionuar gjithmonë si një organ publik i hapur duke publikuar vendimet e saj, pa shmangur paralelisht edhe detyrimet për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë. Vendimet e ERE-s janë thjeshtësisht të aksesueshme nëpërmjet faqes së internetit, por edhe nëpërmjet publikimit në Fletoren Zyrtare.

Përdorimi i teknologjive të reja vlerësohet si një nga mjetet për të çuar edhe më tej praktikën e një organi të hapur ndaj publikut dhe palëve të interesuara. Në këtë drejtim, është në fokusin e ERE-s duke amplifikuar këtë politikë në kuadër të hartimit të një strategjie të digjitalizimit që shërben si një bazë për të ndihmuar në krijimin e një kulture ku të dhënat luajnë një rol të madh në vendimet rregullatore. Për këtë qëllim është e rëndësishme të sigurohet në vijimësi:

- aksesit i rregullatorit në të dhëna, në mënyrë që të prodhojnë vendime, të garantuara nga ky informacion;

- aplikimi i teknologjisë në praktikën rregullatore, duke ofruar shërbime të klientëve dhe më efektive, duke shfrytëzuar platforma të përbashkëta për të përmirësuar shpërndarjen e informacionit në të gjithë aktorët e tregut të energjisë me synimin që të mundësojë shpërndarjen më efektive dhe të koordinuar të informacionit digjital në të gjithë sektorin ku ERE është marrës, por dhe burim informacioni për tregun. Plani i veprimit në këtë drejtim përfshin edhe shfrytëzimin e mundësive për të blerë pajisjet, aplikacionet digjitale mbi përpunimin e të dhënave.

KAPITULLI VII

VLERËSIMI I NDIKIMIT RREGULLATOR

7.1 Transparenca dhe integriteti në veprimtarinë administrative

Në studimin e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD) vlerësohet se është e rëndësishme që rregullatorët të jenë të vetëdijshëm për ndikimet e veprimeve dhe

vendimeve të tyre rregullatore. Një indeks matës për shumë rregullatorë mund të jetë koha e përpunimit të akteve rregullatore ose vendimeve të tjera. Vonesat e panevojshme në proceset rregullatore që mund të imponojnë kosto shtesë për biznesin dhe komunitetin, dhe kështu rregullatorët duhet të përshejtojnë kohën e tyre të përpunimit për vendimet kryesore në kuadër të standardeve të përcaktuara.

ERE është një organ administrativ i pavarur, në përputhje me ligjin për energjinë dhe gazin natyror, që ushtron kompetencat me paanësi dhe transparencë.

Është parimi i konsoliduar në veprimtarinë e ERE-s, që ushtrimi i kompetencave rregullatore të përfshijë procedura të bazuara në pjesëmarrje, si përmes konsultimit të personave, ekspertëve të fushës, ashtu edhe në drejtim të grupeve të gjëra të interesit. Sa më sipër është vlerësuar si një aspekt i rëndësishëm i llogaridhënies duke informuar mbajtësit e interesave në treg në mënyrë adekuate dhe mbledhjen dhe marrjen e mendimeve, opinioneve dhe propozimeve.

7.2 Plani i veprimit konsiston në:

Përfshirja e palëve të interesuara në përcaktimin e strategjive, politikave rregullatore, jo vetëm duke u siguruar që të dëgjohen, por edhe duke siguruar angazhimin për të siguruar një raport të aktiviteteve për angazhimin e tyre periodik mbi ndikimin e akteve rregullatore.

Për këtë qëllim do të vlerësohen edhe praktikën më të mira për ngritjen e strukturave konsultative të përhershme të tillë si komisione të përbashkëta të palëve të interesit që do t'i shërbejnë vendimmarrjes.

Vendosja e indikatorëve të performancës për vlerësim nga vetë rregullatori përbën një element kyç dhe mjaft i rëndësishëm i kësaj strategjie.

7.3 Linjat e veprimit

Në këtë drejtim identifikohen linjat e veprimit si vijon:

Transparenca e vendimmarrjeve:

- publikimi i vendimeve, relacioneve dhe aplikimeve;

- verifikimin *ex post* i ndikimit të rregullores;

- studim i praktikave më të mira për vlerësimin e efekteve të rregullimit me mbështetje nga ekspertë akademikë dhe ekspertë të tjerë me përvojë në fushë.



Të gjitha këto lejojnë rregullatorin që nga njëra anë të kuptojë përgjigjen e operatorëve apo palëve të tjera të interesit, ndaj ndërhyrjeve të rregullatorit nga ana tjetër për të zbatuar çdo veprim korrigjues pas hetimeve, analizave e zbulimit të fakteve, kontrolleve dhe inspektimeve e dokumenteve që lidhen me zbatimin e këtyre akteve. Për këtë qëllim, ERE do të vijojë të kryejë anketime për të vlerësuar ndikimin rregullator.

ERE është e fokusuar për të krijuar një kornizë analitike për të vlerësuar vazhdimisht ndikimin e politikave tona për grupe të veçanta të konsumatorëve në situata të ndryshme. Për këtë, do të përqendrohemi në hartimin e një kornize rregullatore për kriteret e vlerësimit e ndikimit të parimeve të rregullatorit.

Kjo kornizë rregullatore do të përdoret, për të kuptuar ndikimin e politikave tona për grupe të veçanta të konsumatorëve që mund të jenë në situata vulnerabël.

Qëllimi jonë është që kur marrim vendime, ta bëjmë këtë në një mënyrë që më së miri mbron interesat e konsumatorëve ekzistues dhe të ardhshëm, çka përfshin balancimin e përfitimeve të çdo veprimi që marrim kundër kostove që mund të lindin për shkak të këtyre vendimmarrjeve.

7.4 Promovimi i zvogëlimi të barrierave rregullatore dhe shkurtimi i kohës së procedurave rregullatorë

Ka disa pengesa për konsumatorët që të bëjnë zgjedhje të mira në tregun aktual të energjisë, duke përfshirë mos njohjen e opsioneve në dispozicion të tyre dhe mungesa e informacionit të plotë e kompleks nga shoqëritë e licencuara që ushtrojnë aktivitet. Kuptimi i këtyre pengesave dhe sjellja e konsumatorëve dhe kompanive në përgjigje të tyre, merr një rëndësi të veçantë.

Kuadri rregullator duhet t'u mundësojë investitorëve dhe konsumatorëve që të maksimizojnë mundësitë. Në një treg me pakicë të përqendruar, duhet të menaxhojmë ato shërbime universale dhe detyrime të tjera sociale dhe mjedisore, me qëllim garantimin e një tregu konkurrues ku infrastruktura qendrore e teknologjisë dhe standardeve që mbështesin tregun me pakicë të shërbejë si një mekanizëm për rritjen e ndershme të konkurrencës midis furnizuesve për të mbajtur kosto të ulëta për furnizim.

ERE do të marrë përsipër një numër aktivitetesh me qëllim që të sigurohet që tregu të

punojë në mënyrë efikase. Këto përfshijnë mbikëqyrjen e rregullave, monitorimin e aktivitetit të tregut dhe të mundësive të abuzimit në treg. Në veçanti, analiza do të përfshijë shqyrtimin nëse tregu i energjisë elektrike po punon për të siguruar transaksione efikase të tregtisë apo nëse është e nevojshme reforma e tregut për të lejuar mënyra më efektive për të tregtuar duke lejuar përdorimin më efikas të energjisë dhe zvogëlimin e kostove.

KAPITULLI VIII PËRDITËSIMI I KUADRIT RREGULLATOR

8.1 Promovimi i rregullave në përputhje me zhvillimin e kuadrit ligjor të komunitetit të energjisë dhe në vlerësim të specifikave të sistemit energjetik në vendin tonë

Shqipëria ka nënshkruar Traktatin e Komunitetit të Energjisë, i cili mbulon një sërë fushash në lidhje me marrëdhëniet e Shqipërisë dhe BE-së, duke përfshirë energjinë. Ky traktat vendos disa shtylla në lidhje me sigurinë e furnizimit, efikasitetin e energjisë së rinovueshme dhe statistikën, si dhe përafrimin me kuadrin rregullator të vendeve të rajonit me ato të BE-së.

Pikërisht në përputhje me angazhimet e vendit në kuadër të integritetit evropian, ERE do të vazhdojë të punojë me qeverinë dhe aktorët e tregut të energjisë, në vend dhe në Evropë, për të siguruar që korniza rregullatore të jetë në përputhje me detyrimet që lindin nga ky angazhim. Një nga pjesët më të rëndësishme të legjislacionit të BE-së për tregjet e gazit evropian dhe të energjisë elektrike është paketa e tretë e përbërë nga tri rregullore dhe dy direktiva. Një nga synimet kryesore të paketës së tretë ishte liberalizimi i tregut të energjisë, caktimi i autoritetit kombëtar rregullator të energjisë (NRA) të pavarur, përgjegjës për rregullimin e tregut të energjisë në vend.

Një nga aspektet kryesore të paketës së tretë është që të sigurohet që operatorët e sistemit të transmetimit (OST) të jenë të ndara (ose të pavarura) nga interesat e prodhimit dhe furnizimit dhe të jenë të certifikuar si të tilla.

ERE tashmë ka miratuar certifikimin e pajtueshmërisë së OST-së në përmbushje të kërkesave ligjore, proces i cili është në monitorim të vazhdueshëm nga ana e ERE-s.



Përveç kësaj, paketa legislative inkurajon investime afatgjata duke kërkuar Entso-G dhe Entso-E përditësimin e planeve dhjetëvjeçarë të zhvillimit të rrjetit çdo dy vjet. Kjo politikë është reflektuar në rregulloren e miratuar nga ERE për miratimin e planit të investimeve të OST sh.a.

Fokus për punën tonë dhe një element kryesor i paketës së tretë, është kërkesa për të siguruar që konsumatorët të mbrohen. Paketa e tretë përcakton detyrimet për furnizuesit që kanë të bëjnë me çështje, të tilla si: faturat e konsumatorëve, përmbajtja e kontratave të furnizimit, kohën dhe kohëzgjatjen në të cilën të dhënat e furnizimit duhet të ruhen, kohën që duhet të marrë një konsumator për të ndryshuar furnizuesin etj. Paketa e tretë krijoi një kuadër rregullator për të mbështetur një treg të vetëm evropian të energjisë duke zhvilluar kodet e rrjetit evropian. Kodet e rrjetit do të formojnë një grup të detyrueshëm ligjor të rregullave dhe detyrimeve të përbashkëta teknike dhe tregtare që rregullojnë qasjen dhe përdorimin e rrjeteve evropiane të energjisë. Kodet e rrjetit kanë qenë dhe do të zhvillohen në mekanizmat e alokimit të kapaciteteve, balancimin e energjisë, strukturat tarifore të transmetimit dhe ndërveprimin e palëve.

ERE ka punuar ngushtë me palët e interesit duke diskutuar opinione gjatë hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore që përbëjnë kuadrin rregullator të sektorit dhe që mbrojnë konsumatorët.

8.2 Masat rregullatore

Masat që do të merren nga ERE do të jenë:

- ndryshime të nevojshme në rregulloret dhe procedurat e licencimit për njohjen reciproke të licencave;
- angazhimi me operatorët mbi administrimin e kodeve të rrjetit;
- angazhimi me aktoret brenda vendit dhe organizmat evropianë apo dhe me homologë për plotësimin e kuadrit rregullator;
- bashkëpunim ndërinstitutional dhe me institucionet evropiane të lidhura me mekanizma që promovojnë një treg eficient dhe të qëndrueshëm.

Ne do të punojmë që qasjet tona rregullatore të mbështesin një treg konkurrues me përfitime për konsumatorët dhe që nuk cenon interesat e ligjshme të tyre.

Po ashtu do të merren masat e ligjshme dhe të rregullave në vend për të siguruar që ne kemi një

regjim të fuqishëm rregullator, që punon me fokus për konsumatorët dhe promovon hapjen e tregut.

Praktikat rregullatore do të vijojnë të kenë fokus bashkëpunimin me pjesëtarë të tjerë dhe të kenë një kuadër rregullator transparent dhe efektiv.

KAPITULLI IX

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA PËR ÇËSHTJE RREGULLATORE, PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

9.1 Shtirja e bashkëpunimit

Objektivat strategjikë të përshkruar më sipër kërkojnë bashkëpunim të ngushtë me organet e tjera. Duke pasur parasysh natyrën radikale të ndryshimeve në perspektivë dhe kërkesat e tyre për legjislacion të ri, është veçanërisht e rëndësishme bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e tjera. ERE e konsideron të rëndësishme vijimin e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për energjinë përmes ekipeve të përbashkëta për një sërë objektivash, duke filluar nga reforma në tregun e shitjes me pakicë te roli i funksionimit të sistemeve/operatorëve.

I një rëndësie të veçantë është dhe bashkëveprimi me institucione të tjera, të tillë si Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në kuadër të bashkëpunimit për çështjet që lidhen me Zbatimin e masave të plota organizative dhe teknike të sigurisë kibernetike në sistemet e komunikimit dhe të informacionit, Autoritetit të Konkurrencës apo dhe Avokatit të Popullit.

ERE do të vijojë të thellojë angazhimin me organizatat dhe institucionet evropiane, duke e konsideruar bashkëpunimin me organizata, të tillë si një ekspertizë të mirë, për të ndihmuar në sigurimin e rezultateve pozitive për konsumatorët.

Është e qartë që politika që lidhet me sektorin e energjisë është në shumë mënyra ndër-sektoriale, me lidhje të qarta me fushat e politikave të përgjithshme në vend, të tilla si çështjet që lidhen me shërbimet publike, mbështetjen qeveritare për prodhuesit e burimeve të rinovueshme të energjisë, konsumatorët në nevojë apo planet e zhvillimit në vend në tërësi. Prandaj, ne do të vazhdojmë të angazhohjmë drejtpërdrejt burimet tona me institucionet politikëbërëse për të siguruar kuptimin e ndërsjellë të objektivave tanë përkatës brenda fushës së përgjegjësisë dhe kompetencës.



Bashkëpunimi do të përfshijë edhe mbajtjen e takimeve vjetore të ERE-s me konsumatorë, organizata, investitorët për t'i dëgjuar pikëpamjet e tyre, por edhe për të promovuar kuadrin rregullator. Në punën tonë rregullatore, ne mbështetemi dhe jemi mirënjohës për bashkëpunime me organizmat e ndryshëm të përfaqësimit të konsumatorëve, por edhe të pjesëmarrësve të tjerë të tregut në mënyrë të veçantë në drejtim të proceseve konsultuese që ERE zhvillon me qëllim që aktet rregullatore të reflektojnë një ekuilibrim të interesave të konsumatorëve, investitorëve dhe shtetit. Do të merren masa për përmbushjen në vijim të detyrimit për të qenë transparentë, për të arsyetuar vendimmarrjet dhe për të sinjalizuar synimet tona paraprakisht. Eksperienca në shërbimet e furnizimit në këndvështrimin e konsumatorëve, por edhe të ofruesve të shërbimit konsiderohet një aset me mjaft rëndësi, që reflekton një shmangie të barrierave apo krijim të lehtësirave në treg.

ERE do të vijojë t'i japë rëndësi krijimit dhe ruajtjes së lidhjeve të ngushta me konsumatorët e energjisë të të gjitha llojeve: familjet, bizneset dhe përdoruesit e mëdhenj.

9.2 Plani i veprimit

Periodha e adresuar në këtë strategji është afatshkurtër, por ajo gjithsesi kërkon kryerjen e ndryshimeve të rëndësishme jo vetëm në atë që bëjmë, por edhe në mënyrën se si e bëjmë atë.

Fillimi i kësaj periudhe do të shohë, gjithashtu, implementimin e strukturës së re organizative të rregullatorit për të zbatuar masat e përshkruara më sipër. Sidoqoftë, ato imponojnë sfida të reja, të cilat mund të përmbushen vetëm nga një ndryshim i madh në mënyrën se si të gjithë punojmë: shkathtësi dhe shpejtësi më e madhe, më shumë punë midis grupeve të punës për ta bërë ERE një autoritet më efektiv, më të aftë për të bërë një ndryshim pozitiv për konsumatorët dhe mbi të gjitha që ecën e përshtatet me hapat e shpejtë të zhvillimit teknologjik e ekonomik të sektorit energjetik. Vetë Bordi është i vendosur të ndryshojë natyrën e kontributit të tij, aty ku është e mundur drejt një fokusi më selektiv dhe strategjik mbi ndikimin e përgjithshëm të ERE-s në ofrimin e shërbimeve që rezultojnë në benefite për klientët fundorë të energjisë, qofshin ekzistues apo dhe të ardhshëm. Synimi ynë është të botojmë udhëzime më të hollësishme se si kjo strategji dhe përparësitë

tona për këtë periudhë do të drejtojnë punën e ERE-s dhe planin tonë të punës.

Gjatë periudhës së implementimit të kësaj strategjie, ERE do të përgatisë udhëzime të tilla në drejtim të analizës së impaktit të kuadrin rregullator. Bordi do të rishikojë rregullisht progresin që ERE po bën në shpërndarjen e përparësive dhe në ndryshimin e mënyrës së punës.

Përmes raportit tonë vjetor të ndikimit të konsumatorit, ne do të matim dhe publikojmë rregullisht progresin tonë në mbrojtjen e konsumatorëve dhe shpërndarjen e përparësive të përcaktuara në këtë dokument.

KAPITULLI X PËRFUNDIME

ERE do të kryejë analiza/studime të aspekteve të rëndësishme të kuadrin rregullator që kanë të bëjnë me çështjen e shërbimeve të rregulluara.

ERE do të shqyrtojë se si kuadri rregullator duhet të evoluojë në mënyrë dinamike për të mbajtur ritmin me ndryshimet e nxitura nga Covid-19 dhe të gjitha ndryshimet e tjera që ndikojnë në sistemin e energjisë.

ERE do të monitorojë zhvillimet në *CyberSecurity*, gjithashtu.

ERE do të mbajë në fokus të punës dhe vëmendjes konsumatorët dhe tregjet me pakicë.

Një pjesë e madhe e programit tonë të punës 2021–2023 është i dedikuar për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorit dhe për tregjet e pakicës dhe nxitjen e konkurrencës së tregut të pakicës.

ERE do të promovojë dhe do të bëjë përpjekjet më të mira për të përfshirë palët e interesit në vendimmarrje, për të përçarë besimin tonë në vlera, të tilla si: integriteti, thjeshtësia, gjithëpërfshirja dhe mbi të gjitha besimi dhe respekti i ndërsjellë.

Këto vlera përbëjnë kulturën tonë të punës, një kulturë ku të gjithë kanë përgjegjësi për të vepruar për interesin afatgjatë të shoqërisë.



VENDIM
Nr. 75, datë 19.3.2021

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË
BORDIT TË ERE-s, MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA”
SHPK, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT
NR. 34, DATË 4.2.2021, “MBI KËRKESËN
E SHOQËRISË ‘HERA’ SHPK, PËR
SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT
NR. 61, DATË 2.11.2007,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67 dhe të nenit 92, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 37/3 prot., datë 17.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe propozimin e Këshilltares së Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 34, datë 4.2.2021, vendosi:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k., nr. 49, seria NPM07P.

3. Shoqëria “HERA” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendimarrje të Bordit të ERE-s nëpërmjet shkresës nr. 300 prot., datë 13.2.2021, përmes së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme, me shkrim, nga marrja e kësaj shkrese.

- Brenda afatit 30 ditor, brenda të cilit shoqërisë i jepet e drejta për t’u përgjigjur me shkrim, ajo ka depozituar shkresën e protokolluar në ERE me nr.

300/1 prot., datë 17.2.2021, me anë të së cilës ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021.

- Në zbatim të parashikimeve të përcaktuara në “Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimarrjes së Bordit, me qëllim që t’i jepet mundësia shoqërisë të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për sa pretenduar nga ajo në kuadër të kërkesës së saj për rishikimin e vendimit nr. 34/2021.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimarrjes së Bordit të ERE-s, mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 4.2.2021.

2. Shoqëria “HERA” sh.p.k., brenda 10 ditëve punë, të dokumentojë në ERE sa pretenduar në shkresën nr. 300/1 prot., datë 17.2.2021.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojnë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 76, datë 19.3.2021

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË
BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “E-VENTO
SRL ALBANIA” SHPK, PËR RISHIKIMIN
E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s
NR. 32, DATË 4.2.2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 92, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15 dhe 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe të nenit 8, të “Rregullores për



procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 37/2 prot., datë 17.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 32, datë 4.2.2021, vendosi:

“1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 84, datë 17.7.2008, të ndryshuar.

2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., nr. 60, seria NPM08P.

3. Shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave, për heqjen e licencës.”

- Shoqëria “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. është njoftuar për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën e ERE-s nr. 16/1 prot., datë 11.2.2021, nëpërmjet së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.

- Brenda afatit 30-ditor, brenda të cilit shoqërisë i është dhënë e drejta për t’u përgjigjur me shkrim, ajo ka depozituar shkresat e protokolluara në ERE me nr. 16/2 prot., datë 18.2.2021, si dhe nr. 16/3 prot., datë 22.2.2021, me anë të të cilave ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 32, datë 4.2.2021.

- Së fundi, me e-mail-in e datës 15.3.2021, në emrin e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., është depozituar gjithashtu dokumentacion shtesë. Duke qenë se kërkesa e depozituar është në formatin *word* dhe i panënshkruar, e po ashtu duke qenë se bashkëlidhur ka dhe dokumentacion në anglisht, për shkak se mund të ndodhemi përballë rrethanave apo fakteve të reja, vlerësojmë se nevojitet të vendoset kontakti me subjektin për të përcjellë dokumentacionin në formën e kërkuar.

- Në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se pas marrjes së përgjigjes me shkrim

nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t’i paraqesin Bordit propozimin përkatës.

- Në përmbushje të afatit 30-ditor, për të përgatitur relacionin përkatës mbi argumentet e paraqitura nga shoqëria, duke marrë në konsideratë dhe kohën që nevojitet për të vendosur kontaktin me shoqërinë për të saktësuar e përcjellë sipas formës ligjore dokumentacionin e ardhur së fundi, si dhe kohën që nevojitet për të shqyrtuar këtë dokumentacion, e po ashtu duke marrë në konsideratë dhe rrethanat e krijuara nga COVID-19, u vlerësua e nevojshme zgjatja me 30 ditë pune e afatit vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë për rishikimin e vendimit nr. 32/2021.

- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se:

“1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91, të këtij Kodi.

2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 32, datë 4.2.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 77, datë 19.3.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST
SHA, PËR MIRATIMIN E
“RREGULLAVE TË PËRBASHKËTA TË
SHLYERJES PËR SHKËMBIMIN E
ENERGJISË, NË PËRPUTHJE ME
NENET 50 (3) DHE 51 (1) TË
KOMISIONIT RREGULLATOR TË
BASHKIMIT EVROPIAN 2017/2195”**

Në mbështetje të neneve 16, 19 dhe 55, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 15, 19 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 37/4 prot., datë 17.3.2021, të Drejtorive Teknike, mbi shqyrtimin e kërkesës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) për miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”,

konstatoi se:

- OST sh.a., përmes shkresës nr. 4957 prot., datë 14.8.2020, ka përcjell pranë ERE për miratim “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1) të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, të datës 23 nëntor 2017, i cili krijon një udhëzim për balancimin e energjisë elektrike.

- ERE, përmes shkresës nr. 1054/1 prot., datë 11.9.2020, drejtuar OST sh.a., ndër të tjera ka evidentuar, se përkthimi nga gjuha angleze duhet të rishikohet, si dhe nisur nga situata aktuale dhe e mëparshme të shihet nëse OST sh.a. ka bërë një vlerësim të kostove financiare që do të ketë nga aplikimi i mekanizmit të propozuar. Një kërkesë e tillë është e domosdoshme për vlerësimin e mundësive të mbulimit të kostove që do të vijnë nga ky proces.

- Në vijim të komunikimit, OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 4957/3 prot., datë

26.10.2020, ka bërë me dije se e ka rishqyrtuar materialin dhe e ka ridërguar në ERE.

- ERE, nëpërmjet shkresës nr. 298 prot., datë 11.2.2021, ka kërkuar nga OST sh.a., të japë informacionin dhe sqarimet përkatëse lidhur me dokumentacionin e paraqitur në mënyrë që të mund të ezauroheshin të gjithë elementet e pa trajtuara nga komunikimi i mëparshëm nëpërmjet shkresës nr. 1054/1 prot., datë 11.9.2020. Ndër të tjera, në këtë shkresë, është kërkuar të qartësohet nga OST sh.a., nëse kërkohet të miratohen vetëm propozimet e OST-ve kontinentale apo kërkohet të miratohet dhe shpjeguesi i dërguar nga OST sh.a., si pjesë e dokumenteve për miratim. Gjithashtu, është kërkuar të shihet mundësia për të kontaktuar me ENTSO-E, nëse kanë kryer ndonjë simulim ose të përcillet në ERE vlerësimi i vetë OST sh.a., lidhur me parashikimet e kostove të mundshme që mund të ketë operatori lidhur me aplikimin e mekanizmit të ri të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë së propozuar.

- Lidhur me sa kërkuar nga ERE, me shkresën sipërcituar, OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1171/1 prot., datë 22.2.2021, ndër të tjera ka parashtruar si më poshtë vijon:

- Shpjeguesi për propozimin e bërë mbi rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, është dokument shoqërues me qëllim dhënien e detajeve të mëtejshme ezauroese, për të gjithë propozimet e OST-ve të Evropës Kontinentale për rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50(3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator (BE) 2017/2195, të datës 23 nëntor 2017. Në këto kushte shpjeguesi për propozimet e bëra nuk është pjesë e dokumenteve për miratim.

- Në këtë moment, OST sh.a. nuk disponon ndonjë vlerësim financiar për mekanizmin e propozuar, pasi as grupi i punës i ngritur nga ENTSO-E për implementimin e tij, nuk ka kryer simulime për të parë efektet financiare që mund të ketë çdo OST. Gjithsesi, në përgjigje edhe të kërkesës suaj për të përcjellë kostot e mundshme, sqarojmë se këto kosto do mbulohen nga mekanizmi balancues, pra çdo PPB do paguajë për disbalancat e paqëllimshme të krijuara duke injektuar ose tërhequr energji nga interkonjeksioni. Në vlerësimin tonë dhe në analizë të mekanizmit, mund të ketë kosto të pritshme që duhet t'i mbulojë OST-ja, kjo për faktin që çmimi që do të



rezultojë nga zbatueshmëria e rregullave tona të mekanizimit balancues mund të jetë i ndryshëm nga çmimi i shlyerjes për çdo TSO, sipas llogaritjeve të bëra nga qendra koordinative, në përputhje me termat e marrëveshjes. Në këto kushte dhe për sa shprehur me sipër, këto kosto të mundshme do të vlerësohen më qartë gjatë 6 mujorit të parë të aplikimit të kompensimit të devijimeve të paqëllimshme në interkonjeksion, që nuk do të jenë më në natyrë, por palët (TSO-të) do të kompensojnë njëra - tjetrën financiarisht.

- “Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, të datës 23 nëntor 2017, përbëhen nga:

1. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta, për të gjitha shkëmbimet e energjisë të pa qëllimshme, në përputhje me nenin 51 (1), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Ky dokument është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në zonën sinkronike të Evropës Kontinentale, në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e energjisë së paqëllimshme, në përputhje me nenin 51 (1), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

2. Të gjitha propozimet e TSO-ve Kontinentale Evropiane, për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me nenin 50 (3), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

Ky dokument gjithashtu është një propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmisionit në zonën sinkronike të Evropës Kontinentale, në lidhje me zhvillimin e rregullave të përbashkëta të shlyerjes për të gjitha shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje), në përputhje me nenin 50 (3), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi

mbi balancimin e energjisë elektrike. Ky mekanizëm do të përdoret si një mekanizëm i përbashkët i shlyerjes së devijimeve për Evropën Kontinentale për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si rezultat i procesit të kontrollit të frekuencës dhe periudhës së ndryshimit (rritje/ulje).

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 55, pika 3 përcakton se: “Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinje për rregullimin e frekuencës brenda rrjetit, në përputhje me marrëveshjet operationale ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit të rajonit dhe parashikimeve të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal”.

- Duke marrë në konsideratë detyrimet që OST sh.a. ka si palë e ENTSO-E, si dhe faktin që ky mekanizëm i propozuar është një mekanizëm që është dakordësuar nga gjithë OST-të në Evropën Kontinentale, anëtare të ENTSO-E, për rrjedhojë nuk mund të ndryshojë pasi është mekanizëm i përbashkët që afekton gjithë OST-të anëtare të ENTSO-E.

- Rregullat e përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195, priten të aplikohen nga OST-të e Evropës kontinentale, anëtare të ENTSO-E, që nga data 1 qershor 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të përbashkëta të shlyerjes për shkëmbimin e energjisë, në përputhje me nenet 50 (3) dhe 51 (1), të Komisionit Rregullator të Bashkimit Evropian 2017/2195”, të përberë nga:

I. Të gjitha propozimet e TSO-ve kontinentale Evropiane, për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta, për të gjitha shkëmbimet e energjisë të pa qëllimshme, në përputhje me nenin 51 (1), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

II. Të gjitha propozimet e TSO-ve kontinentale Evropiane, për rregullat e shlyerjeve të përbashkëta për shkëmbimet e qëllimshme të energjisë si



rezultat i procesit të kontrollit të frekuencave dhe periudhës së ndryshimit (ritje/ulje), në përputhje me nenin 50 (3), të rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, të 23 nëntorit 2017, për krijimin e një udhëzuesi mbi balancimin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a., dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 80, datë 23.3.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SHPK,
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 38/2 prot., datë 18.3.2021, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për licencimin e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 444 prot., datë 12.3.2021, shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e regjistrimit për aplikim, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas aneksit A, të rregullores së licencimit.

- Aplikimi i shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “e”), Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a” dhe “d”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “c”, “d”, “g”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d”: (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata): plotësuar pjesërisht; Shoqëria duhet të përcjellë në ERE, vërtetimet e prokurorisë dhe të gjykatës së Tiranës për administratorin e shoqërisë dhe po ashtu edhe vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë së qarkut Kukës, për shoqërinë dhe administratorin e saj. Kjo shoqëri ka seli edhe në adresë në këtë qark.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “b”: “Paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)”: plotësuar pjesërisht; shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE versionin final dhe të



audituar të pasqyrave financiare për vitet 2017, 2018 dhe 2019;

- germa “c”: “Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.)”: plotësuar pjesërisht; shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacion mbështetës, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:

- germa “b”: “Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj”): plotësuar pjesërisht; shoqëria duhet të depozitojë sa kërkon kjo pikë e rregullores.

- Germa “e”: “Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi”: pa plotësuar; Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., duhet të dokumentojë në ERE sistemin IT me të cilin do të operojë në vijim.

- Germa “g”: “Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do ti ofrohen klientëve”: pa plotësuar. Shoqëria duhet të përcjellë dokumentacion, sipas kërkesave të kësaj pike të Rregullores, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

NJOFTIM Nr. 4308, datë 9.4.2021

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Rindërtimit Produktiv, Mjedisit dhe Energjisë së Republikës së Greqisë, mbi bashkëpunimin në fushën e bujqësisë, nënshkruar më 15.7.2015, ka hyrë në fuqi më 26 mars 2021.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË Nr. 21/8, datë 9.4.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i tregut të gjësë së gjallë”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Korçë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë.**

KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni



Lista emërore paraprahe e pronarëve të pasurive, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i gjësë së gjallë”

Nr.	PRONARI		TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ZVRPP-së)							Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m²)	Sip. që shpronësohet				
								Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	XHEVAIR	CAUSHLLARI	8564	132/17	ARE	3,000	3,000	100	300,000	300,000	Nuk ka shënime në seksionin “D” dhe “E”.
2	SHTET		8564	132/17/1	ARE	562	562	100	0	0	Nuk ka shënime në seksionin “D” dhe “E”.
3	VASILIKA	KOSTA	8564	132/16	ARE	6,000	6,000	100	600,000	600,000	Nuk ka shënime në seksionin “D” dhe “E”.
4	AFROVITI	KOSTA	8564	132/15	ARE	3,000	3,000	100	300,000	300,000	Nuk ka shënime në seksionin “D” dhe “E”.
5	HENA	VASILI	8564	132/14	ARE	9,000	9,000	100	900,000	900,000	Nuk ka shënime në seksionin “D” dhe “E”.
SHUMA										2,100,000	

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 400 lekë